



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 21 (827876)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 31 maj 2024

“Të jesh student i AFA-së”



Ministria e Mbrojtjes, më 11 qershor organizon në Tiranë, Ditën e Industrisë

Ministria e Mbrojtjes do të organizojë më 11 qershor, në Tiranë, Ditën e Industrisë, një aktivitet që ka për qëllim të prezantojë për kompanitë shqiptare rrugët për t'u bërë pjesë e proceseve të prokurimit me agjencitë e NATO-s dhe Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-ve (DoD), duke kontribuar në fushën e projekteve të rëndësishme për sigurinë kolektive të Aleancës.

Në këtë aktivitet ftohen kompanitë e biznesit të njihen nga afër me veprimtarinë kryesore të dy agjencive të NATO-s, NATO Support and Procurement Agency (NSPA), NATO Communication and Information Agency (NCIA) si dhe Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-s (DoD).

Gjithashtu do të prezantohen procedurat e prokurimit, legjislacioni dhe kushtet/kriteret që duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë në Shqipëri për të marrë pjesë në prokurimet ndërkombëtare, si dhe rritja e bashkëveprimit, shkëmbimi i informacionit dhe ndërveprimi nëpërmjet operatorëve ekonomikë dhe agjencive të NATO-s.

Në aktivitetin që do të organizohet nga Ministria e Mbrojtjes do të adresojë tek partnerët e biznesit qasjen e saj për rijetësimin e industrisë së mbrojtjes. Aktiviteti do të zhvillohet pranë Qendrës së Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.



Nxënësit e shkollës "Servete Maçi" në Tiranë vizituan Komandën e Forcës Ajrore

Nxënësit e shkollës "Servete Maçi" në Tiranë vizituan Komandën e Forcës Ajrore të Shqipërisë, si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore të organizuara nga shkolla.

Vizita kishte për qëllim të njohë nxënësit me punën dhe misionin e Forcës Ajrore, si dhe të nxisë interesimin e tyre për fushat e mbrojtjes dhe sigurisë. Gjatë vizitës, nxënësit u pritën nga oficerët e Forcës Ajrore, të cilët i njohën me strukturën dhe organizimin e Komandës. Ata patën mundësinë të shihnin nga afër avionët luftarakë dhe pajisjet e përdorura nga pilotët, duke marrë informacione të vlefshme mbi funksionimin e tyre. Kjo vizitë u vlerësua shumë nga drejtuesit e shkollës dhe prindërit, pasi u pa si një mundësi e mirë për të zgjeruar horizontet e nxënësve dhe për të nxitur dëshirën e tyre për të mësuar më shumë rreth fushave të mbrojtjes dhe sigurisë. Aktivitete të tilla kanë si qëllim promovimin e aviacionit dhe të nxjerrin në pah profesionalizmin e personelit të Forcave të Armatosura si edhe të inspirojnë brezin e ri të bëhet pjesë e Forcës Ajrore Shqiptare.

AFA merr pjesë në Javën e Administratës publike

Akademia e Forcave të Armatosura mori pjesë në Javën e Administratës publike.

Në këtë aktivitet AFA u përfaqësua me personel akademik dhe ndihmës akademik. Personeli akademik i fakultetit të mbrojtjes dhe sigurisë në AFA u angazhua në kuadër të iniciativës "Administrata Shkon në Universitete".

Dr. Edlira Titini dhe nënkolonel (R) Kosta Jano, pedagogë në Akademinë e Forcave të Armatosura lektuan mbi organizimin dhe funksionimin e NATO-s dhe Konceptin Strategjik të saj për 2024.

Gjithashtu gjatë kësaj jave u promovuan edhe programet e studimit që ofron AFA në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Në përfundim të aktivitetit, Ministria e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni falënderoi pjesëmarrësit e AFA-së.





SHSHPFA, gjeneralmajor Kingji viziton stërvitjen "EFES-24"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, vizitoi stërvitjen shumëkombëshe "EFES-24", e cila u zhvillua në Izmir, Turqi.

Gjatë kësaj vizite ai u takua me shefin e Shtabit të FA-së Turke, gjeneral Metin Gürak, të cilit i shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Turqisë për Forcat të Armatosura të Shqipërisë si dhe marrëdhënien e shkëlqyer që ekziston mes dy vendeve.

Gjatë kësaj vizite, gjeneralmajor Kingji takoi nga afër efektivat e FARSH-së, nga ku falënderoi gjithsecilin për përkushtimin dhe profesionalizmin e lartë të treguar gjatë stërvitjes.



Personeli i anijes në mision "Butrinti", pjesë e aktiviteteve mbi zhvillimin dhe mbarëvajtjen e misionit FOCOPS-24

Gjatë zhvillimit të misionit në detin Mesdhe, u realizuan disa vizita kortezie me përfaqësues të MARCOM si dhe drejtuesit e anijes komandë kroate "Dubrovnik". Këto vizita u zhvilluan në bordin e anijes komandë "Dubrovnik" gjithashtu dhe në bordin e anijes P 134 "Butrinti". Gjatë aktivitetit anija P 134 mori udhëzime specifike për realizimin e misionit. Gjithashtu me rastin e 75-vjetorit e NATO-s, u organizua një aktivitet gjatë të cilit mori pjesë dhe Grupi i Bordingut nga Forca Detare shqiptare me gomonen P 134 "Dea".



Atashetë ushtarakë të NATO-s vizitojnë Forcën Detare/Rojën Bregdetare

Në ambientet e Forcës Detare/Rojës Bregdetare, Komandanti i FD/RB kundëradmiral Adnan Agastra priti në një vizitë zyrtare atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s dhe partnere, të akredituar në Shqipëri.

Kundëradmiral Agastra falënderoi atashetë për prezencën e tyre në këtë takim si dhe iu shprehu vlerësimet për bashkëpunimin me Forcat e Armatosura dhe Forcën Detare/Rojën Bregdetare në planet e modernizimit, fushën e stërvitjeve dhe trajnimeve. Qëllimi i vizitës ishte diskutimi i fushave të ndryshme të bashkëpunimit në të ardhmen midis shteteve tona si dhe u njohën nga afër me planet e modernizimit dhe të kapaciteteve të Forcës Detare/Rojës Bregdetare.



Ditë e hapur në Detashmentin e Mbrojtjes Rajonale, në Mengel, Elbasan

Nxënës të shkollave të mesme jo publike “Iliria” dhe “Rahman School”, në qytetin e Elbasanit, morën pjesë në Ditën e Hapur, që u zhvillua në mjediset e Detashmentit të Mbrojtjes Rajonale, në Mengel, Elbasan. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të fushatës së rekrutimeve në Forcat e Armatosura, me qëllim sensibilizimin e të rinjve për t’u bërë pjesë e FARSH-së.

Komandanti i Detashmentit të Mbrojtjes Rajonale, nënkolonel Vladimir Nasufi, mirëpriti nxënësit, duke i falënderuar për pjesëmarrjen dhe njëkohësisht duke ndarë me ta misionin që ka kjo strukturë e rëndësishme në ndihmë të komunitetit në rastet e emergjencave civile, duke realizuar operacione kërkim-shpëtimi, operacione humanitare si dhe operacione të tjera në rast të fatkeqësive natyrore.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin komandanti i BMEC-së, kolonel Hajdar Gurra, komandanti i QPR-së, kolonel Fadil Ciroka, përfaqësues të Qendrës së Personel Rekrutimit, nënkryetari i Bashkisë Elbasan, z. Asim Sula, përfaqësues të pushtetit vendor dhe lokal si dhe të ftuar të tjerë.

Të rinjtë e shkollave të mesme jopublike, me anë të stendave dhe ekspozimit të pajisjeve speciale nga efektivetë të kompanisë së kërkim-shpëtimit dhe kompanisë EOD, u njohën me aktivitetet e realizuara ndër vite si dhe me mjetet dhe pajisjet moderne që këto struktura përdorin në realizimin e detyrave të tyre.

Qendra e Personel Rekrutimit, nëpërmjet broshurave informuese, njohu të rinjtë me mundësitë për t’u bërë pjesë e Forcave të Armatosura, mundësitë për t’u arsimuar e për t’u punësuar më tej në këto struktura.

Efektivët e kompanisë së kërkim - shpëtimit realizuan dy simulime, atë malor dhe në rast zjarri në qendrat e banuara. Të rinjtë dhe të pranishmit u njohën më nga afër me teknikat që përdorin skuadrat e kërkim - shpëtimit për zbritjen e të aksidentuarve nga terrenet e thyera malore, për evakuimin e të aksidentuarve në rast zjarri dhe për vënien në kontroll të plotë të zjarrit në qendrat e banuara.

Komanda Mbështetëse në çdo kohë do jetë pranë të rinjve dhe komunitetit duke organizuar aktivitete të tilla.



Efektivët e kompanisë EOD, në krye të detyrës për pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme

Specialistë të kompanisë EOD, në Batalionin e Xhenios, janë angazhuar në operacion në bashkinë Klos dhe Tepelenë (fshatrat Dhëmban dhe Sinanaj), pas marrjes së informacionit për gjetjen e municioneve luftarake.

Në bashkinë Klos, efektivetë e kompanisë EOD, kanë identifikuar një minë kundërtank, të cilën e kanë vlerësuar si të lëvizshme, duke bërë më pas transportimin dhe magazinimin në ambientet e Batalionit të Xhenios.

Nga banorët e fshatrave Dhëmban dhe Sinanaj, në komunën Lopës, rrethi Tepelenë është kërkuar ndihmë e specializuar në lidhje me municione të gjetura në këtë zonë. Ekipi i specialistëve EOD, bëri njohjen e municioneve të rrezikshme, të cilat i vlerësoi si të paprekshme dhe të palëvizshme. Duke zbatuar të gjitha rregullat e sigurisë u bë asgjësimi në vend i municioneve të gjetura. Kompania EOD do të vazhdojë angazhimin e saj në operacione me qëllim eliminimin e rrezikut nga municionet e gjetura në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.



Qendra Stërvitore zhvilloi ceremoninë për përfundimin e Kursit Bazë të Nënoficerit

Në mjediset e Qendrës Stërvitore u zhvillua ceremonia për përfundimin e Kursit Bazë të Nënoficerit, faza e dytë, në të cilin morën pjesë 27 kursantë, nënoficerë nga struktura të ndryshme të Forcave të Armatosura.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, komandantë të nën-repartëve vartëse dhe të ftuar të tjerë.

Në fjalën e tij përshëndetëse, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla, pasi falënderoi kursantët për angazhimin maksimal për të ndjekur këtë kurs, nënvizoi se drejtuesit në rolin e komandantit të skuadrës janë një hallkë e rëndësishme në hierarkinë e lidhshme ushtarake, jo vetëm në operacione luftarake por edhe ato jo luftarake.

Kursi Bazë i Nënoficerit, iu shërbeu kursantëve për të marrë njohuritë e duhura teorike, teknike, menaxhuese në specialitetet furnizim, transport –mirëmbajtje dhe xhenio.

Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikata dhe u realizua një foto e përbashkët.

Shtabi i Forcës Tokësore fillon planëzimin e stërvitjes “Përppjekja e Përbashkët 2024”

Në Forcën Tokësore, pasi përfundoi faza e parë e planëzimit të stërvitjes “Përppjekja e përbashkët 24”, filloi Planëzimi Operacional i operacionit “Stuhia”, po në kuadër të stërvitjes 3-shkallëshe të drejtuar nga SHPFA.

Me anë të kësaj stërvitjeje, Komanda e Forcës Tokësore po teston aftësitë e shtabit të FT-së për të planëzuar operacione ushtarake në kuadër të nenit V të NATO-s, aftësitë e komandim-kontrollit (K2), aftësitë e strukturave të regjimenteve të sapo krijuara, ROS dhe bkl për të planëzuar dhe për të zhvilluar operacione sipas konceptit të operacionit, taktikave-teknikave dhe Procedurave Standarde.

Kjo është një stërvitje, në të cilën testohen njëkohësisht edhe aftësitë e nënrepartëve të deklaruar të FT-së, për të dislokuar trupa në mbështetje të NATO-s, për të siguruar dhe garantuar kalimet tranzite të sigurta të NATO-s dhe mbi të gjitha, testimin e K2 dhe sistemeve të komunikimit, për drejtimin e operacioneve ushtarake tokësore në disa zona përgjegjësie operationale brenda vendit. Risi e kësaj stërvitjeje, përveç kompleksitetit është edhe lidhja e stërvitjes “Përppjekja e përbashkët 24”, me 5 stërvitje të tjera tokësore dhe të forcave speciale, të mbështetura edhe nga disa struktura të tjera të Forcave të Armatosura.





Akademia e Forcave të Armatosura në vendin tonë, tashmë i është rikthyer studimeve të saj në programin e ciklit të parë siç është ai bachelor, si një nga vendimet më të rëndësishme politike-ushtarake, lidhur me formimin e oficerit të ri, lidhshiripit ushtarak të së ardhmes. Kjo i jep Forcave tona të Armatosura një mundësi të madhe për të edukuar dhe arsimuar në vendin tonë oficerin e ri, duke e brumosur atë me vlerat e larta të atdhedashurisë.

Tashmë Forcat e Armatosura kanë ndërtuar shkollën e tyre ushtarake kombëtare, AFA, ku traditës më të mirë të shkollës ushtarake të mëparshme iu janë bashkëngjitur vlerat e aleancës ushtarake NATO-s dhe ato të partnerëve, me të cilët Forcat e Armatosura kanë bashkëpunim të vazhdueshëm.

Akademia e Forcave të Armatosura tashmë operon mbi bazën e kurrikulave të rishikuara dhe të reformuara në një sistem studimi 4 vjeçar bachelor, sipas modelit të Akademisë Ushtarake të “West Point”, që është një nga modelet më të mira në botë. Ky program ka filluar në vitin 2023, duke sjellë edhe përmbushjen e objektivave të AFA-së. Është një program i fokusuar mbi 4 shtylla kryesore, ku “Programi Akademik” zë peshën kryesore të programit me rreth 180 kredite, “Programi i Karakterit”, i cili pavarësisht që nuk zë pjesë në kurrikulën mësimore, ai mbulon në fakt të gjithë aktivitetin 24 orësh të studentit, pra është një program ku studenti është 24 orë nën vëzhgim, d.m.th. tek studenti shihet mënyra e sjelljes së tij, e shoqërimit me të tjerët, e të angazhuarit në grupet e punës dhe ato sportive etj. Shtylla e tretë është “Përgatitja Fizike”, e cila zë një vëmendje të veçantë, pasi përgatitja ushtarake e oficerit të ri, lidhshiripit, kërkon një përgatitje të fuqishme, dhe shtylla e katërt është “Përgatitja Ushtarake”, e cila ka për detyrë të kthejë një civil në një ushtarak të devotshëm për t’i shërbyer vendit në të gjitha operacionet luftarake, jo luftarake si dhe ato të dhënies ndihmë ndaj popullsisë, siç janë situatat e emergjencave civile, etj. Edukimi dhe stërvitja e studentëve të AFA-së që ata të jenë të gatshëm për të gjitha sfidat që iu kërkojnë, ka për qëllim që ata të jenë të gatshëm që nesër të drejtojnë trupa në çdo vend që kërkojnë nga Shqipëria që të kontribuojë në misionet e saj në kuadër të Aleancës së NATO-s.

Këta oficerë që përgatiten sot, të jenë nesër të aftë të drejtojnë ushtarët në strukturat ushtarake. Ja se çfarë thonë titullarët e AFA-së, si dhe studentët e tyre, ekselentë të vitit të parë akademik.

Prof. As. Dr. Eteleva Smaçi, zv/rektore e AFA-së
Të flasësh në ditët e sotme për edukimin e Forcave tona të Armatosura është një vlerë e shtuar, pasi të flasësh për FA-të është një informacion i domosdoshëm për të gjithë shoqërinë. Përgatitja e Forcave tona të Armatosura është një përgatitje e përhershme, pra FA-të edukohen dhe arsimohen në vazhdimësi jo thjesht për luftën, por për t’u përgatitur për t’i shërbyer në mënyrë të veçantë atdheut, vendit të tyre. Akademia e FA-së iu ktheje nivelit të parë të studimeve në vitin 2020, pra ishte një nismë, e cila u mor nga lidhshiripi ushtarak dhe politik i kohës për të pasur mundësi dhe që ne ta edukonim dhe arsimonim oficerin tonë në vendin tonë me atë atdhedashuri, sepse deri në vitin 2020, programi bachelor nuk zhvillohej në vendin tonë, prandaj kjo ka qenë një nga arritjet më të mëdha, pasi siç e thashë pa mbështetjen e lidhshiripit politik dhe ushtarak, kjo nuk do të ishte bërë e mundur. Pikërisht në vitin 2020, lindi nevoja që ne të ndërtonim një shkollë ushtarake kombëtare, të cilën e kishim traditë, por t’i bashkëngjishim asaj vlerat më të mira të aleancës të Atlantikut Verior me të cilët ne bashkëpunojmë në mënyrë të vazhdueshme. Fillimisht u pa e nevojshme që të ndërtohej modeli siç kanë të gjitha institucionet e Arsimit të Lartë, pra me një bachelor 3+2, sipas sistemit të Bolonjës. Por në rrugëtimin tonë, ne pamë që ndoshta një model më i mirë dhe një model më i përshatshëm, do të na jepte jo vetëm oficerin e së ardhmes, por do të na jepte liderin e së ardhmes, sepse kjo është dhe motoja mbi të cilën bazohen kurrikulat tona, pra një ushtarak dhe një lider i së ardhmes. Ne vendosëm të reformonim kurrikulat sipas modelit 4 vjeçar, të një prej akademive më prestigjioze në të gjithë botën, siç është ajo e “West Point”. Pra ky rishikim kurrikulash erdhi nga një binjakëzim, jo një binjakëzim tradicional, por një binjakëzim të tillë, se si ata e kanë ndërtuar edukimin e tyre ushtarak mbi katër kolona kryesore, të cilat ne i kemi përshtatur për Akademinë tonë.

Kolonel Ilirian Dautaj, dekan i AFA-së
Në vitin 2020 në AFA hapëm tre programet e reja, të cilat ishin “Shkencat Ushtarake”, “Teknologji Informacioni” dhe “Navigim dhe Komandim Detar në Fushën e Mbrojtjes”.

Programin e parë “Shkencat Ushtarake”, Akademia e zhvillon me pedagogët e saj, kurse “Teknologji Informacioni” dhe “Navigim dhe Komandim Detar”, e kemi në bashkëpunim me universitetin

“Të jesh student i AFA-së”

e Durrësit “Aleksandër Moisiu”. Duke parë që programi trevjeçar nuk arrinte objektivat që ne i kishim vënë vetes, u dakordësuam që të kishim një program 4 vjeçar dhe si një nga akademitë që ne i përafroheshim ishte akademia “West Point” e SHBA-së dhe duke filluar nga viti 2023, që ishte viti i parë i punës, ne kemi kaluar në sistemin 4 vjeçar.

Katër shtyllat kryesore që ne i kemi fokusuar në program janë “Programi Akademik”, i cili zë peshën kryesore të programit me rreth 180 kredite, “Programi i Karakterit”, i cili mbulon të gjithë aktivitetin 24 orësh të studentit, Shtylla e tretë është “Përgatitja Fizike”, e cila zë një vëmendje të veçantë, sepse shohim që nxënësit nuk i kushtojnë një vëmendje të madhe përgatitjes fizike në shkollën e mesme, pasi përgatitja ushtarake e oficerit të ri, lidhshiripit kërkon një përgatitje të fuqishme fizike, dhe shtylla e katërt është “Përgatitja Ushtarake”, e cila na detyron të kthejmë një civil në një ushtarak të devotshëm për t’i shërbyer vendit në të gjitha operacionet qofshin këto luftarake, jo luftarake, por dhe dhënia e ndihmës ndaj popullsisë në rastet e fatkeqësive të ndryshme. Këto janë katër shtyllat të cilat ne i kemi vënë vetes detyrë për të arritur objektivat për studentët në vitin 2023.

Dr. Gentian Hoxhalli, përgjegjës departamenti në AFA
Akademia e FA-së ofron në ciklin Bachelor tre programe studimi, bachelor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, bachelor në “Shkenca Komunikimi” dhe bachelor në “Teknologji Informacioni”, program nga i cili buron drejtpërsëdrejti dhe departamenti të cilin unë drejtoj dhe, ndërkohë kemi prej disa vitesh edhe programin në ciklin e dytë, programin “Master”, si në rastin konkret “Master Profesional në Sigurinë Kibernetike”, që është pikërisht një master i dedikuar dhe sidomos në situatën aktuale, i hapur në vitin akademik 2020-2021, i cili përgatit të gjithë kuadrot specialistët apo dhe ekspertët në fushën e sigurisë kibernetike. Është një master 1 vjeçar që realizohet tek ne, masteri është publik, pra që i dedikohet jo vetëm ushtarakëve të FA-së, por është një master që i dedikohet të gjithë specialistëve në fushën e IT-së, që realizojnë këtë master, pra për të gjithë auditorin ushtarak dhe jo ushtarak që vjen dhe regjistrohet pranë FA-së. Ky master ka teknikalitetin, ose specifikën e vet, me të gjithë situatën që jemi përballur kohët e fundit. Është një master që ka një kurrikul moderne, një kurrikul përshtatur edhe sipas filozofisë së “West Point”, me lëndë dhe module të sigurisë kibernetike, gjithashtu mendoj se është një fat për ata që e ndjekin këtë master, për sa i përket AFA-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes në tërësinë e vet, për mbështetjen e tyre që japin, duke qenë se ne kemi dhe njësi të dedikuara për sigurinë dhe mbrojtjen kibernetike, siç është dhe “Njësia Ushtarake për Sigurinë Kibernetike”, që është pjesë e këtij masteri. Pra ekspertët e kësaj njësie lektorojnë në këtë master, apo dhe strukturat e tjera që ka Ministria e Mbrojtjes, të dedikuara për pjesën e sigurisë së të dhënave, sigurisë kibernetike, mbrojtjen nga sulmet kibernetike dhe realisht japin një vlerë të shtuar jo vetëm për FA-të, por edhe për tregun e lirë, duke qenë se ekspertët e diplomuar apo të nxjerrë nga ky master janë realisht të gatshëm për të dhënë eksperiencën e tyre në të gjitha fushat ku integrohen.

Ndërkohë AFA ka bashkëpunim me universitete të ndryshme publike dhe jo publike, për shkëmbimin, marrjen ose dhënien e lektorëve, por edhe për ndërtimin e kurrikulës që në gjenezën e këtij masteri.

AFA ka iniciativë dhe qëllim zgjerimin e të gjitha ofertave akademike. Jemi në prag të hapjes të dy masterave, të atij shkencor në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, i cili do të startojë gjatë vitit të ardhshëm akademik 2024-2025 dhe masterit tjetër shkencor në “Shkenca Kompjuterike dhe Inteligjencë Artificiale”, që është një master, ku janë bërë të gjitha hapat ligjore dhe pritet licencimi nga ana e Ministrisë së Arsimit. Ky master është një master sfidues për ne, në dijeninë tonë nuk ka një master të tillë në nivel Akademik në vendin tonë. Kjo sfidë është mbështetur nga lidhshiripi i Ministrisë së Mbrojtjes, nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, gjithashtu nga universitete partnere, duke marrë në konsideratë që rrjeti ynë akademik nën ombrellën e NATO-s, është i gjerë, por dhe duke parë dhe kurrikulat dhe programet që ofron “West Point” në këtë prizëm, për masterat në inteligjencë artificiale. Programi i Masterit në fjalë u ndërtua i tillë dhe lektorimet dhe përzgjedhja e stafit akademik do të jetë ndër më të mirët që do t’i japin Shqipërisë kontributin e drejtpërdrejtë me studentët që do të regjistrohen në këtë master, studentë ushtarakë dhe jo ushtarakë.

Flasin tre studentë ekselentë të vitit të parë të Akademisë së Forcave të Armatosura

Katerina Mimini:
Jam studente e vitit të parë në Shkenca Komunikimi të programit Bachelor. Dëshira për të filluar këtë shkollë ka qenë tërësisht personale. Asnjë prej familjarëve të mi nuk është një ushtarak. Unë jam e para në familjen time që kam zgjedhur të jem ushtarake. Sigurisht përveç dëshirës time për t’u bërë ushtarake ishin edhe disa favore që na i mundëson kjo shkollë, përveç degës time të preferuar “Shkenca Komunikimi”. Kur kam ardhur në fillim në këtë Akademi ndoshta dhe mund të mos kem pasur të gjitha këto pritshmëri që më ka ofruar kjo Akademi, të cilat jo vetëm që i kanë plotësuar pritshmëritë e mia, por madje edhe i kanë tejkaluar ato. E them këtë pasi kjo Akademi ka kushte shumë të mira, tarifa vjetore është zero, programet mësimore dhe angazhimi dhe mësimdhënia që pedagogët zhvillojnë tek ne është shumë i efektshëm. Për sa i përket përbërjes së klasës sime ka më shumë studentë djem se sa studente vajza, por ajo që ne ndiejmë dhe kemi e them me plot gojë se bashkëpunimi në Akademinë e Forcave të Armatosura është gjëja më kryesore.



Enea Nazaj:
Jam student i vitit të parë Bachelor, në “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, që është dhe dega që unë kam përzgjedhur. Kam zgjedhur degën “Teknologji Informacioni” nën uniformë, tërësisht me dëshirën time pasi kushtet që na ofron akademia janë shumë të mira dhe jo vetëm kushtet për anën mësimore, por edhe ato të jetesës që ne bëjmë këtu brenda, por edhe për formimin që ne marrim. Duke ardhur nga jeta civile, nga gjimnazi në fillimet tona të para ka qenë pak e vështirë kalimi nga jeta civile në atë ushtarake, por tashmë ky transformim ka ndodhur dhe ne jemi mësuar. Formimi ynë them se është shumë i mirë, ne kemi mendime të lira, mendimet nga jashtë nga ana civile për ne janë shumë më ndryshe janë shumë pozitive për ne. Unë jam shumë i kënaqur me Akademinë dhe dita - ditës ne po mësojmë gjëra të reja dhe ndjehemi shumë mirë këtu, brenda këtij garnizoni që po na formëson në profesionin e dashur.

Mateo Lleshi:
Është kënaqësi të jap mendimin tim bashkë me dy kolegët e mi lidhur me Akademinë ku ne po studiojmë. Jam student vitit të parë Bachelor, në degën “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes”. Kam zgjedhur pikërisht degën “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes”, duke qenë se vij nga një familje me prejardhje ushtarake, jam rritur që i vogël me ndjenjën e uniformës dhe me ndjenjën që duhet t’i shërbejmë atdheut. Zgjedhja e degës time vjen që nga gjimnazi dhe dëshira që kam pasur për të studiuar një degë siç është “Marrëdhënie Ndërkombëtare”, pasi dhe qasja ime është më tepër tek lëndët shoqërore se sa tek lëndët ekzakte, prandaj kam zgjedhur dhe degën “Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes”.

Ndërsa lidhur me uniformën meqenëse unë vij nga një familje ushtaraku, jam realist kur them se sa më afër situatës të jesh aq më e prekshme është ajo. Uniforma që kam zgjedhur është përgjegjësi dhe krenari, shumë krenari. Unë me plot krenari u them shokëve se jam në këtë shkollë me dëshirën time më të madhe dhe ju them dhe atyre që mbarojnë gjimnazin sot, të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, pasi uniforma është privilegj për secilin nga ne.



**GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ:
EKSPERT PËR SK, RAJONIN DHE NATO-N**

Sic është e mirënjohur, më 23 maj 2024, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, shpalli 11 korrikun “Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Srebrenicë”. Sigurisht një akt shumë i vonuar, por që i bën nder “institucionit të kujtesës” si dhe vlerave të qytetërimit në mbarë globin.

E thënë më shkurt, 11 Korriku do të njihet botërisht si data e gjenocidit të kryer në qytezën e Srebrenicës (me rreth 30 mijë banorë në vitet ’90), ku u vranë më shumë se 8 000 boshnjakë myslimanë, kryesisht gra, pleq, djem dhe vajza të moshës 12 deri 77 vjet. Masakra u krye në 11-18 korrik 1995, nga Ushtria Serbe nën udhëheqjen e gjeneralit famëkeq Ratko Mlladiq, para-ushtarakë të MB të Serbisë, qindra vullnetarë rusë, etj.! Shumë më herët se OKB-ja, Gjykata e Hagës e kishte shpallur gjenocid këtë masakër.

Rezoluta jo vetëm shpall gjenocidin në Srebrenicë por u kërkon vendeve anëtare: “dënimin pa rezerva të çdo mohimi ose veprimeve që i madhërojnë të dënuarit për krime lufte, si dhe të përfshijnë në programet arsimore fakte të vërtetuara gjyqësore për gjenocidin në Srebrenicë”.

Sigurisht, Gjermania meriton mirënjohjen për iniciativën, si dhe 84 vendet demokratike, që e votuan këtë akt fisnik “mos-harrese” ndaj 8 000 të masakruarve në Srebrenicë si dhe për mesazhet që i përcollën botës së qytetëruar “kurrë më/never again” për paqen dhe të ardhmen euroatlantike të qytetarëve, jo vetëm të Ballkanit Perëndimor: “E vërteta vonon por kurrë nuk harron”. E propozuar nga Gjermania (do të doja që bashkë-propozuese të ishte edhe RSH...), që ka vuajtur pasojat për krimet çnjerëzore të Hitlerit, i jep shumë vlerë dhe i bën nder shtesë lidhshimit të Berlinit Zyrtar.

Nga ana tjetër, meriton damkosjen gjeopolitike lista e 19 vendeve, si Rusia, Bjellorusia, Kuba, Mali, çuditërisht Hungaria (i vetmi vend anëtar i NATO/BE), që e refuzuan rezolutën si dhe ndaj mendjeve të ndryshkura jo vetëm në Beograd, Banja Luka, që nuk e lexuan si një mundësi për të shpëtuar të ardhmen euroatlantike të Ballkanit nga oscilacionet e krimeve çnjerëzore të Millosheviçit si dhe interesat e Rusisë – Putiniste.

Në mënyrë të posaçme, e gjej delikuate dalldisjen z. Vučić, që flamurin Serb në OKB e shpalosi mbi shpatullat/interesat e (mbi) pushtetit të Tij, por në fakt e poshtëroi kombin, duke e unifikuar/shpërdoruar atë si leckë të gjakosur nga një masakër kriminale të Millosheviçit dhe zullumqarët rreth tij!

Ndërsa për hartën e 68 vendeve abstenuese (Greqi, Sllovaki, Qipro, pra 2 vende të NATO-s dhe 3 të BE-së), zhgënjimi nuk do të mjaftonte për të përshkruar shterpësinë e intuitës dhe përgjegjësive gjeopolitike për moralin dhe dinjitetin e shteteve respektive në interes të jetës, paqes dhe vlerave të qytetërimit?!

Në shtesë, në kapacitetin e Ekspertit të Sigurisë Kombëtare, Rajonit dhe NATO-s, e çmoj në kohën e duhur që përtej tallavasë bolsheveke jo vetëm në Beograd – Moskë – Banja Luka, të sjellë një përmbledhje mbi rrethanat dhe përmasat e masakrës së Srebrenicës; hartën e qëndrimeve pro dhe kundër si dhe mësim/mesazhe strategjike që përcjell nga kjo masakër çnjerëzore për ballkanasit dhe mbarë njerëzimin:

Në 1991, BRSS u shpërbë paqësisht (në dhjetor ’91 Soviet Suprem u dha pavarësi 15 Republikave, përfshi Ukrainës). Ndërkohë në korrik 1991 ishte shpallur “i vdekur zyrtarisht” edhe Traktati i Varshavës!

Ndërsa ish-Federata e Jugosllavisë, që për 40 vjet kishte përfituar në të gjitha aspektet nga asnjënjësia pragmatike e Titos: “as lindje as perëndim”. Vitet 90-të, e gjetën FY me një regjim ku e ku më të moderuar në raport me pronën, të drejtat e njeriut, besimin fetar si dhe ekonomikisht, krejtësisht tjetër p.sh me RPSSH të rraskapitur dhe të gjuhëzuar nga regjimi 45 vjeçar i Enver Hoxhës.

Por përkundër pritshmërive optimiste për oportunitetet gjeopolitike nga statusi asnjënjës, zgjedhjet e para pluraliste në 1990, i fituan ekstremistët e Millosheviçit. Në mesin e 1991, Sllovenia, Kroacia dhe Maqedonia shpallën pavarësinë, ndërsa në vjeshtën e 1991 ushtria Serbe, rrafshoi Vukovarin dhe bombarduan si barbarë qytetin antik të Dubrovnikut!

Konflikti etnik dhe fetar në Bosnje - Hercegovinë mbetet më i përgjakshmi. Pavarësisht se pavarësia e B-H u njoh ndërkombëtarisht në prill 1992, ushtria e Gjeneralit famëkeq Karaxhiç, nuk e njohu dhe e mbajti të rrethuar Sarajevën për 1425 ditë (5 Prill 1992 – 29 shkurt 1996). Krimet e luftës arritën kulmin me masakrën e Srebrenicës (11-22 Korrik 1995), ku siç e sipër-përmendëm u vranë barbarisht 8 000 burra, gra dhe fëmijë myslimanë. Kjo masakër jo vetëm damkosi përjetësisht si kriminel Millosheviçin dhe mbi 100 pasues të Tij, por ngriti edhe pikëpyetje të forta zhgënjimi për pafuqinë e OKB-së (kaskave Blu), BE, etj.

Mbas ndërhyrjes së NATO-s, Marrëveshja e Dejtonit (14 dhjetor 1995), i dha fund luftës 4-vjeçare. Bosnje-Hercegovina u njoh si shtet i tre popujve dhe dy entiteteve, B-H dhe Republika Srpska. Por disa strategjistë/kolegë të kohës, theksuan se: “kjo nuk ishte një paqe 100% e drejtë, por sigurisht ishte më e drejtë se vazhdimi i luftës”. Fatkeqësisht, koha iu dha shumë të drejtë. 30 vjet mbas

“Srebrenica, damka e gjenocidit për Millosheviç(ët)izmin!”



Dejtonit – Vuçiçët/Dodikët e frymëzuar nga Putini, kërcënojnë statukuonë gjeopolitike të B-H dhe të krejt rajonit.

Kosova, mbeti fushëbeteja e fundit e masakrës së Millosheviçit (1998 – qershor 1999), me mbi 15 000 të vranë, 5 000 të zhdukur dhe rreth 1 milion shqiptarë të dëbuar barbarisht nga trojet dhe pronat e tyre. Gjithsesi do të ishte e padrejtë mos të përsërisim mirënjohjen kombëtare pasi: pa ndërhyrjen e fuqisë ushtarake të SHBA/NATO/MB, një masakër ndaj shqiptarëve do kishte kaluar përmasat e Srebrenicës, ndërsa vetë çlirimi Kosovës ishte mision i pamundur.

Pas luftës (1999), paqja pati më shumë se një “dekadë mjalti”, ku vendet e Ballkanit (me histori të përgjakshme) në vend të luftës u përfshinë në garë kush do të anëtarësohej më shpejt në NATO dhe BE. Falë mbështetjes së SHBA-së, sigurisht edhe aspiratës dhe përpjekjeve nacionale: “Kroacia, Sllovenia, janë anëtare të NATO/BE. Shqipëria, Mal i Zi, MV në NATO”, bashkë me Serbinë (që do të pijë nga 4 nëna = Moska, Brukseli, Uashingtoni, Pekini), presin te dera përmbushjen e standardeve të anëtarësimit në BE”. Kosova dhe B-H vijnë përpjekjet dëshpëruese drejt NATO-s dhe BE-së.

Lexim gjeopolitik i hartës pro dhe kundër gjenocidit të Srebrenicës:

Fatmirësisht, para dhe pas rezolutës kemi qëndrime, mbështetje dhe mesazhe të forta nga Uashingtoni, Brukseli, Berlioni, Londra, etj.: “Rezoluta nuk shënjestron asnjë shtet anëtar dhe nuk ngarkon kurrsesi me përgjegjësi kolektive asnjë grup njerëzish (sigurisht as popullin Serb), ndërsa të gjithë e kemi detyrim t’i pranojmë faktet, ta mësojmë të vërtetën, t’i nderojmë viktimat si dhe t’i mbështesim përpjekjet për t’i gjetur dhe identifikuar viktimat dhe për t’i ndjekur dhe dënuar autorët”.

Ndërsa për paqen dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor, Aleanca Euroatlantike (USA/NATO/BE) ka paralajmëruar se: “Nuk do të tolerohen përpjekjet për shpërbërjen e B-H si dhe mbeten të vendosur për mbrojtjen e marrëveshjes së Dejtonit dhe për të mos lejuar një luftë tjetër në Rajon”.

Për më qartë, Ambasadori i SHBA-ve në OKB, z. Robert Wood, pas miratimit të gjenocidit për Srebrenicën, theksoi: “Rezoluta patjetër do të kontribuojë për të siguruar që gjenocidi i kryer nga forcat serbe në Srebrenicë, në korrik 1995, nuk do të përsëritet më kurrë, ndërsa mirëpresim vendimin e Përfaqësuesit të Lartë për B-H për të ndaluar pjesëmarrjen në zgjedhje të personave që kanë kryer gjenocid”.

Nga ana tjetër, këto qëndrime do të mbeten një mesazh për të qetësuar cinizmin e Rusisë/Lavrovit, i cili rezolutën në fjalë e cilësoi si: “Shantazh për të nënshtruar serbët, që t’u bashkohen sanksioneve ndaj Rusisë”, si dhe kërcënoi se: “Kjo do të shkaktojë pasoja në stabilitetin dhe paqen e Ballkanit”!?

Sigurisht, fushata kundër rezolutës së OKB-së udhëhiqet nga presidenti serb Vuçiç. Ish-Ministri i Millosheviçit bëri (por humbi) gjithçka për të penguar miratimin: “Rezoluta për Srebrenicën do të thotë hapja e kutisë së Pandorës për paqen e Ballkanit Perëndimor”. Edhe politikanët serbë në B-H e paraqesin rezolutën si simbol të “turpit, frikës dhe trishtimit për çdo serb”? Kjo pasi Srebrenica, keq-përdoret për të përhapur frikën mbi popullin serb, nëse nuk ndjekin liderët politikë si Dodikun dhe Vuçiçin?!

Ndërsa politikanët boshnjakë iu referohen vendimeve të Gjykatës së Hagës, nga e cila dhjetëra politikanë dhe ushtarakë të Republikës Srpska u dënuan për gjenocidin në Srebrenicë. Presidenti i Partisë

së Veprimit Demokratik, Izetbegović, paralajmëroi OKB-në se të dënuarit për gjenocid në Srebrenicë glorifikohen si “heronj Serbë” nga politikanët dhe opinioni publik në RS, ndërsa në vetëdijen kolektive përpjekjet për të vendosur fajësinë individuale perceptohet si thirrje për faj kolektiv të serbëve në B-H dhe Serbi.

Gjithsesi, besoj se rikthimi i mendjeve të ndryshkura dhe investimi shtetëror i Beogradit te burimet e luftës së përgjakshme, mund të kënaqë ekstremistët, krimin e organizuar, oligarkët dhe ushtrinë e pushtetarëve të korruptuar, por pa asnjë diskutim është një thikë mbas shpinës së paqes, masave të mirëbesimit reciprok dhe axhendës së integritetit Euroatlantik të 5 vendeve të rajonit. Ndërsa përkundër kësaj, rezoluta për Srebrenicën është një mundësi e re për t’u përballur me të vërtetën si dhe një shans i ri për të mbjellë frymën e mirëbesimit dhe bashkëjetesës paqësore mes popujve dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Pesë mësimet si dhe 5 mesazhe strategjike që mund të nxjerrim nga gjenocidi i Srebrenicës:

Së pari, mësimi ulëritës: “Nëse harrojmë, e keqja përsëritet edhe më mizorisht”. Neonazistët e Rusisë - Putiniste; Kim-Jongtë e Azisë dhe Shtetet apo Organizatat, Terroriste; ushtarët/pasuesit e oscilacioneve të Millosheviçit në Beograd apo Dodikët e droguar nga interesat e Moskës dhe korrupsioni, jo vetëm po kërcënojnë sovranitetin territorial të Ukrainës martire; paqen në lindjen e mesme, sigurinë dhe axhendën e integritetit të 5 vendeve të Ballkanit Perëndimor, por po sfidojnë seriozisht vlerat themelore, rendin global, fuqinë e aleancës Euroatlantike (USA/NATO/UK/BE) si dhe stabilitetin demokratik të shoqërisë njerëzore.

Së dyti, rezoluta për Srebrenicën do të shërbejë jo vetëm si ilaç shërimi nga urrejtja shekullore, por edhe si mundësi për t’u përballur me të vërtetën, ndërsa përgjegjësia për gjenocidin i mbetet makinerisë kriminale të Millosheviçit dhe kurrsesi e gjithë popullit serb.

Së treti, gjenocidi i Srebrenicës mbetet ende si një kampanë zgjimi për 32 vendet e NATO-s, rrjedhimisht edhe për vendin tonë, jo vetëm të mbështesim me deklarata diplomatike Ukrainën, NATO-n, SHBA-të, por në këtë betejë “për jetë a vdekje” me të keqen e përbashkët, të marrin përgjegjësitë, për të përmirësuar rrënjësisht Institucionin e mos-harresës, sistemin dhe kapacitetet e sigurisë në përballjen me neo-nazistët e rinj dhe sundimtarët e marrosur që po kërcënojnë më shumë se kurrë që nga Lufta II Botërore, jetët njerëzore, rendin global, vlerat demokratike si dhe interesat euroatlantike.

Së katërti, sigurisht Srebrenica meriton të skalitet si gjenocid edhe për mesazhet aktuale dhe që mbeten të përjetshme për mbarë njerëzimin: për lirinë, paqen, sigurinë, stabilitetin demokratik dhe vlerat themelore, do të na duhet të mos harrojmë kurrë. Për më tepër, ja vlen dhe duhet çdo ditë vigjilencë, solidaritet, pra duhet çdo ditë të punojmë/luftojmë fortë, me përgjegjshmëri dhe sakrificat!

Së pesti dhe e fundit: falni por mos harroni (Forget but not forgive) që mbetet si “EPITAF” jo vetëm për B-H e masakruar, Kosovën e martirizuar si dhe për MV, Malin e Zi, Kroacinë, Slloveninë, Shqipërinë, si dhe vetë Serbinë që e paguan shumë shtrenjtë marrëzinë e Millosheviçit, por edhe si mirënjohje e merituar për SHBA-të, NATO/GE/BE, që kontribuan (dhe vijnë të mbajnë peshë kritike) aq shumë për paqen e rajonit, fatkeqësisht ende të mbërthyer nga oscilacionet e urrejtjes dhe gjakderdhjes shekullore.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Na ndodh që shpesh t’i bëjmë pyetje vetes sesi do të reagonim nëse do të ishim pjesë e një eksperimenti social, sesi do të komportoreshim, cilat strategji do të ndiqnim, cilat do të ishin pikat tona të forta apo të dobëta?!

Po ashtu, është një mister i natyrës njerëzore për të aluduar rreth limitit që ne si qenie njerëzore kemi përballë sfidave, të cilat përfundojnë me një shpërblim qoftë ai monetar apo pushteti.

Në ç’pikë mund të arrijë njeriu përballë urrejtjes, neverisë apo edhe nëpërkëmbjes si efekt i një loje apo eksperimenti?

Një pikëpyetje e madhe është edhe fakti se deri ku mund të arrijmë ne si njerëz nëse na jepet liri për të bërë çfarë të duam me të tjerët, për t’u hakmarrë, për të nxjerrë komplekset tona apo edhe thjesht për të çliruar të keqen brenda vetes? **A është liria në vetvete anarkia më e madhe për qeniet njerëzore?**

Ajo që testohet është limiti njerëzor, deri në çfarë pike mund të arrijë natyra njerëzore nëse i jepet liria për të bërë gjithçka me një individ të dorëzuar.

Sa njerëz jemi, sa të aftë jemi të lëndojmë tjetrin dhe deri ku shkon kolapsi dhe çmenduria njerëzore?

Në këtë eksperiment arrijmë të kuptojmë se njerëzit kanë instinkte shumë të errëta brenda vetes, të cilat për efekt të të tjerëve apo dukjes i shtypin çdo ditë këto instinkte, por arrijnë të lëndojnë të tjerët në momentin që ata janë të pambrojtur dhe vulnerabël.

Sa më i mbuluar të jetë identiteti i dikujt, aq më i predispozuar është ai për të ndërmarrë vendime të errëta, për të thënë të vërtetat apo edhe për të bërë keq. Sa më hapur të merren vendimet aq më të predispozuar janë njerëzit për t’u veshur me hipokrizi. Eksperimente të tilla sociale janë parë gjithmonë në shoqëri, rasti i “Big Brother”, një format i cili shfaqet në media dhe pëlqehet në mënyrë të shfrenuar nga njerëzit, tregon se vetë shoqëria pëlqen lojën që bëhet me në epiqendër njerëz dhe ndjenjat apo veprimet e tyre. Këto formate tregojnë se deri në cilën pikë mund të shkojë kompromisi njerëzor për të fituar para dhe pushtet.

Shfaqet gjithashtu hapur fakti sesi urrejtja prodhon fobi kolektive, duke na treguar se shoqëria akoma nuk ka arritur ta tejkalojë materien dhe instinktin primar, i cili lidhet me logjikën e sundimit të më të fortit.

“Big Brother”, edhe pse një spektakël argëtues për shumëkënd që e sheh nga ekrani, është po aq një eksperiment social i rrezikshëm.

Je i vëzhguar 24 orë nga disa dhjetëra kamera, të cilat transmetojnë në publik veprimtarinë tënde të ngushtë.

Gjithçka intime që ndiqet nga disa mijëra njerëz përmes ekranit, të cilët jo vetëm të përflasin por nxjerrin nga fundi i dheut edhe ato gjëra që t’i vetë ke harruar se i ke bërë. Ndaj këtu duhen nerva të forta për ta përballuar, edhe pse gati të gjithë pjesëmarrësit në kor thonë se nuk duan t’ia dinë për atë që thuhet jashtë. Pak e vështirë për t’u besuar kjo gjë.

Për më tepër që të shfryrët e energjive negative tanimë ka vend ku merr ngushëllim, sepse në modë janë rrjetet sociale, ku mund të thuash çfarë të të dojë qejfi edhe me një identitet fals.

Dhe pas një anonimatit mund të thuash shumëçka, të vërteta e trillime për një person që nuk është në shijen tënde. Pavarësisht se çfarë kostoje ka fjala jote tek personi vetë, kur të dalë nga ngujimi e të përballat me furinë e inateve, apo te familjarët e tij, të cilët edhe po të mos duan do t’u shkojnë në vesh gjithfarë thashethemesh.



SA MË I MBULUAR TË JETË IDENTITETI I DIKUJT, AQ MË I PREDISPOZUAR ËSHTË AI PËR TË NDËRMARRË VENDIME TË ERRËTA, PËR TË THËNË TË VËRTETAT APO EDHE PËR TË BËRË KEQ. SA MË HAPUR TË MERREN VENDIMET AQ MË TË PREDISPOZUAR JANË NJERËZIT PËR T’U VESHUR ME HIPOKRIZI. EKSPERIMENTE TË TILLA SOCIALE JANË PARË GJITHMONË NË SHOQËRI, RASTI I “BIG BROTHER”, NJË FORMAT I CILI SHFAQET NË MEDIA DHE PËLQEHET NË MËNYRË TË SHFRENUAR NGA NJERËZIT, TREGON SE VETË SHOQËRIA PËLQEN LOJËN QË BËHET ME NË EPIQENDËR NJERËZ DHE NDJENJAT APO VEPRIMET E TYRE. KËTO FORMATE TREGOJNË SE DERI NË CILËN PIKË MUND TË SHKOJË KOMPROMISI NJERËZOR PËR TË FITUAR PARA DHE PUSHTET.

Në këtë pikë, edhe pse cilësohet si lojë, eksperimenti social thellohet në favor të përplasjeve dhe akumulimit të inateve.

Formati i ‘Reality Show’ ka një sukses të pamohueshëm dhe “Big Brother” është një program i ndjekur nga miliona spektatorë, madje edhe nga ata që nuk e pranojnë.

Ndërkohë që një ‘Reality Show’ i tillë qëllon që të dalë nga shinat, sepse edhe pse fjala “lojë” përdoret si mbulesë, sërish inatet dhe pasionet janë të vërteta aq sa prej tyre mund të lindin konflikte fizike.

Vetë lojtarët gjatë gjithë kohës deklarojnë publikisht se janë nën një presion të vazhdueshëm.

Është ky spektakël argëtues, për shumëkënd, ku njerëzit bëjnë kompromise me veten për të marrë çmimin 100 milion.

Por ky eksperiment që mund të jetë i bukur dhe argëtues për ata që e shohin nga ekrani, lë jo pak pasoja tek aktorët.

Dhe teksa lënë shtëpinë e famshme, të gjithë kanë të njëjtën frazë për të thënë: Ishte një eksperiencë fantastike.

Padyschim

Por duhet të kalojnë dhe ca kohë për të kuptuar pasojat, po aq sa dhe mbyllja disa mujore në kushtet e pandemisë, ku fill pas kësaj ca njerëz kishin nevojë për një psikolog e ca të tjerë për një psikiatër.

Ndaj, lum ata që dalin sa më parë nga dhomat

shumëngjyrëshe e të arregduara bukur dhe që janë veç karremi, ku mbahen varur njerëzit të cilët kur shkelin aty u duket se janë futur në botën e çudirave.

A je ti aty brenda, unë?

Në të gjitha formatet e këtij eksperimenti hidhen kauza të ndryshme, për të cilat publiku është tepër i ndjeshëm, dhe rëndom dëgjohet nga brenda atyre mureve të thuhet ‘unë jam ti’. Jo kjo është individuale dhe gjithkush ka personalitetin, vlerat dhe moralin e tij.

Prandaj jemi ndryshe sepse mendojmë, ndiejmë, urrejmë në forma të ndryshme.

A jemi ne humanët ‘kaviet’ e duhura për këto lloj eksperimentesh?

Tashmë jetojmë në kohën e respektimit të detyruar të lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se duhet të lejojmë shprehjen e gjërave, të cilat individualisht mund të mos na pëlqejnë apo që venë në dyshim sistemin e vlerave morale e të sjelljes tradicionale. Zakonisht këto “eksperimente sociale” zhvillohen në moment kyç, pikërisht atëherë kur shoqëria është në prag të intensifikimit të “reformave sociale” të caktuara.

Nuk duhen parë të izoluar sjelljet dhe ekzibicionet individuale, në këtë eksperiment social. Përkundrazi sociologjikisht ato duhen konsideruar produkt, reflektim i gjendjeve sociale, nëpër të cilat po kalon shoqëria jonë.

Profesor Kristaq Gjino, skënderbegasi që bëri emër në fushën e shkencave ekzakte

Skënderbegasi Kristaq Gjino është një nga nxënësit e shkollës “Skënderbej”, që bëri emër në Shqipëri në fushën e shkencave ekzakte. Kristaq Gjino lindi më 15 prill 1953 në fshatin Barmash të rrethit Kolonjë. Pasi mbaroi shkollën 8-vjeçare në Barmash, si dhe vitin e pare të shkollës së mesme në Ersekë, në shtator të vitit 1969, filloi studimet në shkollën e mesme të përgjithshme ushtarake “Skënderbej”, në Tiranë (direkt në vitin e dytë).

Në qershor të vitit 1972, përfundoi studimet pranë kësaj shkolle me rezultate të shkëlqyera, falë këtyre rezultateve që arriti, nga Ministria e Mbrojtjes iu dha bursë për të vazhduar studimet në degën e matematikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Rezultatet e larta në mësimet në dy vitet e para, bënë që ai të fitojë të drejtën për të vazhduar programin studimor në degën matematikë speciale, dega 5-vjeçare.

Në vitin 1977 përfundon studimet universitare me rezultate shumë të larta (mesatarja në lëndët matematike për të 5 vitet ishte mbi 9.7). Menjëherë pas përfundimit të studimeve emërohet pranë repartit ushtarak 2915 (më vonë 4455), dega e Radio-zbulimit, me detyrën e specialistit të kriptanalizës. Pas përfundimit të stazhit dhe mbrojtjes së diplomës universitare (me notën 10), në tetor të vitit 1978 titullohet oficer aktiv. Në qershor të vitit 1983 emërohet me detyrën e komandantit të repartit të kriptanalizës, një pozicion me përgjegjësi të lartë për atë kohë. Për 9 vjet me radhë, deri në tetor të vitit 1992, punoi me përkushtim për realizimin e detyrave të ngarkuara. Gjatë atyre viteve nuk kanë munguar rezultatet mbresëlënëse dhe me rëndësi për vendin. Për rezultatet e arritura sektori i kriptanalizës është vlerësuar dhe nga udhëheqja më e lartë e asaj kohe. Me ndryshimin e sistemit, në kuadër dhe të ristrukturimit të Forcave të Armatosura, në tetor të vitit 1992, me kërkesën e tij doli në lirim. Menjëherë fillon punë si pedagog matematike pranë katedrës së matematikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës.

Me kalimin e viteve u bë titullar i disa lëndëve, duke punuar në vazhdimësi e me këmbëngulje për ngritjen e mëtejshme të nivelit matematik. Dallohet për marrëdhënie të veçanta me kolegët dhe studentët. Për studentët ai ka qenë gjithmonë jo vetëm një pedagog i dashur dhe i respektuar, por edhe një prind i dytë.

Ka kryer kualifikime jashtë vendit, 5 javë në Paris për marrje eksperience dhe azhurnim me arritjet bashkëkohore në fushën e kriptanalizës, dy muaj pranë universitetit Paris-6 në Francë (1996), dy muaj pranë Universitetit të Janinës, Greqi, në kuadër të një programi të financuar nga NATO (1996), dy muaj pranë Universitetit të Janinës, Greqi, në kuadrin e programeve Tempus (1998), në kuadër të bashkëpunimit midis Universitetit të Tiranës dhe një universiteti në Gjermani ka shkruar shumë herë, me periudha 1-3 mujore pranë Universitetit të Siegen-it.

Tituj dhe grada: Në vitin 1977 fitoi gradën shkencore “Doktor i shkencave” në matematikë. Në vitin 2014 ka marrë titullin “Profesor i Asociuar”.

Është titullar lënde në Analiza matematike, Analiza Matematike 2, Analiza Komplekse 1 dhe Analiza Komplekse 2, është hartues programesh në Analiza matematike 1 dhe Analiza Matematike 2, për degët Matematikë dhe IMI, në Analiza matematike 1 dhe Analiza Matematike 2, për degët Informatikë dhe në Analiza Komplekse 1 dhe Analiza Komplekse 2, për degën Matematikë.

Kristaqi ka këtë aktivitet shkencor:

Disa studime në fushën e kriptanalizës: Referime/Postera në konferenca dhe kongrese shkencore; Referime/Postera në konferenca dhe kongrese shkencore në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në bazë të një vlerësimi paraprak dhe janë botuar në “Proceeding”; artikuj shkencorë origjinalë, artikuj shkencorë origjinalë si autor i parë, artikuj shkencorë origjinalë që janë botuar në revista shkencore të huaja, të njohur, me bord editorial; artikujt shkencorë origjinalë që janë botuar në një revistë shkencore të huaj, me faktor impaktim.

Ka këto botime tekstesh të nivelit Universitar: Analiza Matematike I. (Teori), për studentët e degës Matematikë, Fizikë,



Informatikë, etj., Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti i botimit 2011; Analiza Matematike II. (Teori), për studentet e degës Matematikë, Fizikë, Informatikë, etj., Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti i botimit 2011; Analiza Matematike II, (Ushtrime), për studentët e degës Matematikë, Fizikë, Informatikë, etj., Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti i botimit 2011; Analiza Matematike II, (Ushtrime), për studentet e degës Matematikë, Fizikë, Informatikë, etj., Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti i botimit 2011; Analiza Komplekse I. (Teori dhe Ushtrime, me Aleko Mingën), për studentët e degës Matematikë dhe IMI, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti i botimit 2012; Analiza Komplekse II. (Teori dhe Ushtrime, me Aleko Mingën), për studentët e degës Matematikë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, viti i botimit 2012.

Është gjithashtu bashkautor ose redaktor shkencor, i më shumë se 20 tekstesh matematike për shkollat e ciklit të ulët.

“Përse s’mund ta harroj shkollën ‘Skënderbej’?”, shkruan profesor Kristaq Gjino.

Më dha edukatën e punës, këmbënguljen, ndershmërinë,



“PËRSE S’MUND TA HARROJ SHKOLLËN ‘SKËNDERBEJ’?”, SHKRUAN PROFESSOR KRISTAQ GJINO. MË DHA EDUKATËN E PUNËS, KËMBËNGULJEN, NDERSHMËRINË, KORREKTESËN DHE DASHAMIRËSINË NË MARRËDHËNIET ME NJERËZIT. MEGJITHËSE ISHTE SHKOLLË ME SYNIM PËR PËRGATITJEN E KUADROVE QË DO TË PUNONIN NË STRUKTURAT E FORCAVE TË ARMATOSURA, UNË EDHE SOT KUJTOJ ME NOSTALGJI GJITHË STAFIN PEDAGOGJIK TË ASAJ SHKOLLE, PËR PËRKUSHTIMIN NDAJ PUNËS DHE SJELLJEN MUND TË THEM PRINDËRORE NDAJ NXËNËSVE TË SHKOLLËS.

korrektesën dhe dashamirësinë në marrëdhëniet me njerëzit. Megjithëse ishte shkollë me synim për përgatitjen e kuadrove që do të punonin në strukturat e Forcave të Armatosura, unë edhe sot kujtoj me nostalgji gjithë stafin pedagogjik të asaj shkolle, për përkushtimin ndaj punës dhe sjelljen mund të them prindërore ndaj nxënësve të shkollës. Ata ishin të veçantë që të gjithë, por po të më kërkohej të veçoja ndonjërin, ky do të që profesori im i matematikës, Pavli Bici. Faleminderit profesor, që dite të ma shtosh akoma më shumë dashurinë për matematikën. Sa i dashur e korrekt, po aq edhe i rreptë. Megjithëse po mbushen 25 vjet që jam larguar nga strukturat e Forcave të Armatosura, vitet e punës pranë këtyre strukturave i kujtoj me nostalgji. Puna më bën që shpesh herë të takoj prindër studentësh që punojnë në forcat e armatosura. Takimi me ta, veç të tjerave, me kujton jetën ushtarake. Shumë nga kolegët e mi ma njohin dobësinë që kam për ushtarakët. Takimet me shokët e vjetër, që nga shkolla “Skënderbej” e deri te ata me të cilët punova për rreth 15 vjet, janë akoma më të veçanta. Edhe pas kaq shumë vitesh që jam larguar nga ushtria, me disa prej tyre, komunikojmë më njëri-tjetrin duke iu drejtuar njëri-tjetrit “Ej komanda, ç’ kemi?”.



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Një libër për dashuritë e jetës

Kohët e fundit ish-ushtaraku Mehmet Deliu botoi librin “Dashuritë e jetës sime”, me mbresa dhe kujtime nga jeta e mbushur plot episode dhe ngjarje të shumta, me mjedise shkollore, pune dhe ushtarake të përshkruara plot jetë, gjallëri e bukuri. Libri portretizon me ngjyra të ndezura dhe realiste jetëshkrimin dhe personalitetin e nënkolonel Mehmet Deliu, ushtarak i aviacionit shqiptar, si dhe kuadër aktiv dhe i suksesshëm në bashkitë Fushë-Krujë e Krujë. Në libër mësojmë se Mehmet Deliu ka lindur në një familje të thjeshtë, në Valias të Tiranës. Shkollën 8-vjeçare e ka filluar në shkollën “Rexhë Deliu”, Rinas, dhe e ka mbaruar në shkollën “Korb Muça”, Qerekë, Tiranë, për të vijuar studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Ka kryer studimet e larta në Shkollën e Aviacionit, në Vlorë; Shkollën e Lartë të Partisë dhe Akademisë së Diplomacisë Shqiptare, në Tiranë. Libri përqendrohet në jetën dhe veprimtarinë si nxënës dhe student të Mehmet Deliu, në episode e ngjarje që shprehin karakterin dhe formimin e tij kulturor e human. Nga libri dalin mësimet të vlefshme për jetën, për rëndësinë dhe vlerat që ka kultura dhe dija, shkollimi dhe kualifikimi, e veçanërisht edukata prindërore, përvoja në përballimin e punëve të vështira, si dhe në zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara që i shfaqen shpeshherë njeriut në jetë. Formimin e tij Mehmet Deliu në libër ia dedikon shkollës, mësuesve e pedagogëve, familjes, babait të tij.

U formua në “fidanishten” e ushtrisë

Autori vlerëson shkollën e mesme “Skënderbej” dhe shfaq respekt për nxënësit e saj të parë që ishin partizanët e vegjël, djemtë e dëshmorëve të luftës, fëmijë në nevojë dhe pa prindër nga të gjithë krahinat e vendit. Në “bankat” e shkollës u ulën fillimisht mjaft partizanë pionier të vegjël, që kishin luftuar e që nisën studimet në “Shkollën e Pionierëve të Luftës”. Më pas me vendim të posaçëm, do të quhej Shkolla e Mesme Ushtarake “Skënderbej” dhe u bë “fidanishtja” e Ushtrisë, e cila kishte mbi 2 mijë nxënës në katër vite së bashku. Në bankat e kësaj shkolle, Mehmet Deliu mori mesazhe të rëndësishme për jetën, e cila, siç shprehet “nuk është fushë me lule, por është një fushë betejë plot sfida, që në mënyrë figurative do ta krahasoja me një det të turbullt, me dallgë të fuqishme, që doemos duhet vozitur fort për t’i kapërcyer”.

Nga faqet e librit mësojmë se në shkollë kërkohej seriozitet, përkushtim dhe përgatitje e lartë, karakter i fortë, disiplinë, qëndrueshmëri dhe motive nxitëse e frymëzuese, si dhe aftësi, që skenderbegasi i mori dhe i fitoi gjatë kryerjes të punëve të vështira. Gjithashtu Mehmet Deliu na paraqitet nxënës e student, drejtues rinie i zgjedhur nga të rinjtë, duke u formatuar në një kuadër dhe njeri plot kulturë, që me kurajë civile dhe ushtarake flet dhe mobilizon ushtarë, shokë dhe kolegë. Kudo në repartet e ushtrisë shfaqti aftësi të dukshme dhe kulturë, në mbledhje e kuvende të mëdha e të rëndësishme të kohës, në kongrese rinie, në aktive, në seminare edukative e profesionale, në takime e mbledhje shoqërore, kulturore, letrare, etj. Tek figura e ushtarakut Mehmet Deliu u bënë bashkë vlera dhe cilësi të rralla, që e portretizojnë atë nga veçoritë dhe karakteristikat e oficerit model në ushtri dhe në armën e aviacionit. Ai shfaqti kudo përgatitje teknike e profesionale, sociale e kulturore, i përkushtuar dhe serioz, me karakter të palëkundur, me virtyte dhe aftësi dhe përballor me sukses detyrat e ngarkuara në jetë.

Për figurën e pilotëve shqiptarë

Në jetën ushtarake, Mehmet Deliu ka mbajtur gjithmonë qëndrim të kujdesshëm, të ekuilibruar, njerëzor, me synimin për të ndihmuar shokun, kolegun, vartësin dhe eprorin në punë. Ai shpreh falënderim dhe mirënjohje për shokët, kolegët dhe eprorët, të cilët i kanë qëndruar në krah, e kanë mbështetur për të ecur në jetë, për ushtarakët Sali Dibra, Klement Aliko, Ilo Marjani, Kristaq Burda, Seit Vuçaj, Kristofor Peçi, Astrit Jaupi, etj. Si ushtarak i armës së aviacionit luftarak, autori ndalet më gjerë tek kjo armë, te fuqia e saj luftarake e mbrojtëse, modernizimi i vazhdueshëm, arsimimi dhe kualifikimet e pandërprera të pilotëve dhe të trupës përgatitore në shërbimin e fluturimeve, duke përcjellë te lexuesi njohuri për ushtrinë dhe fuqinë luftarake të aviacionit. Në qendër ai vendos figurën e pilotëve shqiptarë, të ushtarakëve të rinj, energjikë dhe atdhetarë, të shkolluar, të përgatitur dhe të kualifikuar, duke u përqëndruar në Shkollën e Lartë të Aviacionit në Vlorë. Në libër autori shpalos disa karakteristikat të veçanta dhe të qenësishme të efektivave mësimorë e trajnues dhe të ushtarakëve e drejtuesve të Shkollës së Lartë të Aviacionit. Përpara lexuesit shfaqen njerëz me botë të pasur shpirtërore, të aftë dhe të përgatitur, seriozë dhe të përkushtuar, të vetëdijshëm për detyrat e vështira që kryenin.

Në libër njihesh me emra të nderuar dhe të pavdekshëm pilotë heroikë, që kanë dhënë jetën në kryerjen e detyrës, duke ngelur përjetësisht në Panteonin e Nderit të Atdheut, si Niko Hoxha, Luto Sadikaj, Idriz Hoxha, Jani Tarifa, etj. Libri jep informacion për fuqinë e armës së aviacionit luftarak shqiptar, lexuesi njihet me aerodromet ushtarake, me vendstrehimet, me pistat ku avionët

Nënkolonel Mehmet Deliu, nder dhe dinjitet në elitën ushtarake shqiptare



ngriheshin e uleshin vazhdimisht, ku kuadrot dhe pilotët shfaqnin aftësi dhe profesionalizëm, si dhe për teknikë që kujdeseshin për mirëmbajtjen dhe gatishmërinë e avionëve supersonikë. Në bazën e Gjadrit, ku krahas detyrave me karakter edukativ e politik, ai kreu edhe detyrat ushtarake si shef në radio-stacion, komandant grupi i radio-dritës dhe shef Operacional. Ndërsa në bazën e Rinasit, kreu detyrën shefit të shtabi bazë. Në Komandën e Forcave Ajrore kreu detyrën shefit të zyrës së Komandantit të Forcave Ajrore etj. Në të gjithë detyrat e kryera nënkolonel Deliu, u shqua për korrektësi, maturi, për cilësi e aftësi të larta ushtarake e profesionale, për seriozitetin dhe përkushtimin, duke bërë që t’i dëgjohej fjala dhe mendimi.

Ndërsa shkrimtari Viron Kona në parathënie të librit shprehet se: “E mbaj mend Metin, që kur ishte oficer i ri, me ëndrra dhe pasione, i përkushtuar plotësisht rreth aviacionit, por dhe i aktivizuar në rrethin e Vlorës sa herë ndihej nevoja për punën, energji dhe përvojën e tij... Meti e mendonte dhe e vlerësonte detyrën që merrte përsipër dhe s’thoshte kurrë jo, teksa të gjithë ne ishim të sigurt që askush tjetër nuk mund ta kryente më mirë detyrën sesa Mehmet Deliu. Libri është mësimdhënës dhe bien në sy vlerat edukative, informacioni i hollësishëm për probleme që kanë të bëjnë me anën psikologjike dhe karakterin njerëzor të ushtarakut, motivet e fuqishme shpirtërore dhe atdhetare nga të cilat udhëhiqeshin. Mehmet Deliu bën përshkrime për tërmetin e 15 prillit 1979, tërmetin e 26 nëntorit 2019, pandemisë COVID 19, opinione për luftën në Ukrainë etj. Të gjitha këto flasin për punë studiuese të tij, për nivel shkrimor, por tregojnë se ushtarakët, oficerë apo ushtarë, ishin të lidhur ngushtë me popullin.

Autori dhe lexuesi trishtohen dhe dëshpërohen për shkatërrimin e ushtrisë, të reparteve të rëndësishme të veçantë, siç ishin aerodromet, vendstrehimet e avionëve, që u shkatërruan “sa hap e mbyll sytë”. Kështu, avionë dhe vendstrehime e pista u shndërruan në grumbuj hekurishtesh, gërmadha e mbeturina pa vlerë. Autori shpreh dëshpërimin e dhimbjen e tij, mban qëndrim ndaj shkatërrimtarëve të ushtrisë në tërësi dhe atyre që shkatërruan armën e aviacionit. Të gjitha armatimet e ushtrisë, kanë qenë djersa dhe munda i një populli të tërë, që ka sakrifikuar shumë për modernizimin e ushtrisë, por që në një periudhë fare të shkurtër u shkatërrua plotësisht, duke e lënë krejt të zbuluar mbrojtjen e atdheut. Me këto shigjeta demaskuese e kritike autori përshkruan dhe analizon në përgjithësi e veçanërisht ngjarjet e vitit 1997.

Viti 2006 ishte viti i fundit i shërbimit të ushtarakut Mehmet Deliu në Forcat e Armatosura. Më datën 1 shtator 2006, në moshën 52 vjeç, pas 4 vitesh shkollë të mesme ushtarake “Skënderbej” në Tiranë, 3 vite shkollë të Lartë të Aviacionit në Vlorë, pas 30 vitesh karrierë si oficer, në moshën e pjekurisë, me energji e përvojë, me shumë dëshirë dhe nevojë për t’i shërbyer familjes dhe shoqërisë, për shkak të reformës, doli në rezervë.

Aftësia për t’u përshtatur e “komandantit”

Intelektuali Mehmet Deliu e kishte përgatitjen, formimin dhe aftësitë e duhura që të vetë-orientohej. Ai u aktivizua në Organizatën e Veteranëve të LANÇ-it dhe me Organizatën e Dëshmorëve të Atdheut. Me meritë u punësua në Bashkinë Fushë-Krujë dhe më pas në Bashkinë e Krujë, në detyrën e drejtorit të Burimeve Njerëzore. Edhe në sektorët e bashkive, në punët e pushtetit lokal ne shohim protagonistin Mehmet Deliu një luftëtar të jetës, një kuadër të përgatitur dhe të aftë për t’i shërbyer popullit, halleve dhe shqetësimeve, zgjidhjes së problemeve që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë njerëzit në këtë periudhë të tranzicionit demokratik. Në këto organe pushteti, u shqua si kuadër i denjë dhe organizator, njohës dhe interpretues i drejtë i ligjeve dhe këmbëngulës në zbatimin e tyre. Mehmet Deliu ka nderuar gjithnjë dëshmorët dhe heronjtë e luftërave për liri e demokraci, kurdoherë ka qenë në krye të organizimit të festave të mëdha historike, të 28 dhe 29 Nëntorit, të 5 Majit - Ditës së Dëshmorëve, por ai ka treguar kujdes dhe ka këmbëngulur për riparimin, mirëmbajtjen dhe pamjen e simboleve të LANÇ-it, për riparimin dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe Muzeut të Dëshmorëve të Atdheut, të cilat ishin thyer e shkatërruar pothuajse tërësisht. Një punë të veçantë bëri për restaurimin e lapidarëve të çetës, të batalionit, të brigadës dhe të Dëshmorëve të Atdheut, për përkujtimin dhe festimin e përvjetorëve të krijimit të BrXXIII Sulmuese dhe të çlirimit të Krujës.

Ai u gjend në krye të organizimit të veprimtarive për Heroin Kombëtar, Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, duke shfrytëzuar mundësitë reale që jep Fushë-Kruja dhe Kruja, pasi në trojet e tyre, kryetrimi shqiptar ka zhvilluar betejat të shumta sulmuese e mbrojtëse, duke dalë gjithnjë fitimtar kundër hordhve të panumërta të ushtrive shumëkombëshe osmane. Në Fushë-Krujë kaloi vitet e fundit të jetës së saj edhe heroina e rezistencës kosovare, legjendarja Shote Galica, ndaj, në respekt të emrit dhe të veprës së saj heroike, veteranët e Fushë-Krujës dhe të Krujës nën kujdesin e tij janë përkujtuar vazhdimisht me nderim emrin dhe veprën e saj heroike.

Në libër spikat në mënyrë të veçantë mbështetja që ka pasur Mehmet Deliu nga familja e tij, e veçanërisht nga bashkëshortja, Dëshira, e cila i ka qëndruar vazhdimisht pranë, i është gjendur dhe e ka mbështetur sa herë që atij i duhej të ishte në krye të detyrave të rëndësishme, sidomos në bazat ushtarake të Rinasit dhe të Gjadrit, por edhe në shumë momente të tjera, kur Metin e gjadronin me urgjencë detyrat apo ngjarjet e papritura që ndodhnin në repartet e aviacionit ku ai shërbente. Vend të veçantë në libër zë dhe deputeti i Kuvendit Popullor, djali i madh Denisi, ushtarak si babai, i shkolluar, i aftë dhe i përgatitur fizikisht dhe ushtarakisht. Denisi si ushtarak me përvojë ka kryer detyra si komandant grupi i Forcave Speciale të Ushtrisë, oficer i misioneve luftarake në mbështetje të paqes dhe luftës kundër terrorizmit, në përbërje të ushtrisë amerikane, me mision në Afganistan, komandant grupi i Njësisë Speciale të Gardës dhe shefi i Sigurisë së Vetingut. Sot është deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Libri “Dashuritë e jetës sime” të Mehmet Deliu nga përmbajtja, tematika, forma dhe vlerat artistike të tij, përcjell mesazhe që na vlejné në jetë, tërheqës për çiltërsinë e shprehjes dhe të prezanton me tipa dhe karaktere. Libri ka përshkrime të mjediseve ku vepronin repartet ushtarake, përshkruan aerodrome dhe pista moderne të aviacionit. Në libër tërheqin vëmendje portretizim i figurave dhe karaktereve njerëzore, që i japin vlerë personazhit, ku gjen përcaktime të figurshme mjaft të goditura si “burrë i gjatë”, “qitës i talentuar”, “qëllonte cigaren 25 m larg”, etj. Në përfundim mund të them se autori dhe protagonist i këtij libri. Ushtaraku Mehmet Deliu, ka qenë dhe mbetet modeli i ushtarakut të karrierës: serioz, i aftë, i përgatitur fizikisht dhe profesionalisht, i përkushtuar, zemërgjerë e miqësor, korrekt dhe i përpiktë deri në detaje. Kryeministri Edi Rama, duke ia njohur vlerat dhe aftësitë drejtuese e organizuese... i është drejtuar me respekt me emrin “komandant”.

Madhështia e dijetarit EQEREM ÇABEJ

Në konkursin e shpallur nga Mbretëria e Shqipërisë, gjuhëtari Eqrem Çabej, më 1937-n, paraqiti krijimin “Për një himn të ri me frymë thjesht shqiptare”, të cilin e tërhoqi shumë shpejt.

Përse e tërhoqi nga konkursi?

Çabej e tërhoqi këtë krijim nga konkursi, kur mori vesh se në të merrnin pjesë personalitete, të cilët i nderonte e i çmonte lart e me të cilët nuk e quante veten të denjë të matej, bën me dije Shtëpia Botuese “Çabej”, që drejtohet nga e bija e dijetarit, Brikena.

I madhi Çabej do të thurte këto vargje për më të bukurin flamur, atë për të cilin dhanë jetën me mijëra djem dhe vajza.

HIMNI I FLAMURIT

Buzë valësh që rreh deti
Përmbi shkrepë mijvjeçare
Përmbi mal ku sundon shqipja
Edhe rrit gjini krenare,
Ku jep burri besa-besën
E ku vdes si vdiq qëmotit,
Po valon e lëshon hije
Flamuri i Kastriotit.
Ku rreh ti, atje po rrahin
Gjithë zemrat e bujarët.
Ku valon, atje valon dhe
Gjaku i nxehtë i Shqipëtarvet,
Atje lidhet besa e Zotit
Për liri dhe për Atdhe!
Se Shqipnia asht' e jona!
Për at gjak e për këtë dhe!
Te kështjell' e bardh' e Krujës
Rreth e qark e mbi bedena
U mblodh komb' i fort' i Arbrit
Rreth Shqiponjës me dy Krena.
U droth toka fort e vjetër
Kur i ranë kaq dëshmorë
Rreth flamurit të përgjakun
Si dhandurë me kunorë.
Ku rreh ti, atje po rrahin
Gjithë zemrat e bujarvet,
Ku valon, atje valon dhe
Gjaku i nxehtë i Shqipëtarvet,
Atje lidhet besa e Zotit
Për liri dhe për Atdhe!
Se Shqipnia asht' e jona!
Për at gjak e për këtë dhe!



“ÇABEJ E TËRHOQI KËTË KRIJIM NGA KONKURSI, KUR MORI VESH SE NË TË MERRNIN PJESË PERSONALITETE, TË CILËT I NDERONTE E I ÇMONTE LART E ME TË CILËT NUK E QUANTE VETEN TË DENJË TË MATEJ, BËN ME DIJE SHTËPIA BOTUESE “ÇABEJ”, QË DREJTOHET NGA E BIJA E DIJETARIT, BRIKENA.

Jeta dhe vepra e Eqerem Çabej

Gjuhëtari Eqrem Çabej, lindi më 7 gusht 1908, në Gjirokastrë. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes. Në vitin 1921 mbaroi shkollën fillore, më pas ai fitoi të drejtën e një burse, të dhënë nga prefektura e atëhershme e Gjirokastrës, për të vazhduar studimet e mesme e të larta jashtë shtetit dhe kështu ai nisi, ashtu si edhe të rinj të tjerë shqiptarë, rrugën e mërgimit në kërkim të diturisë. Studimet e larta i mbaroi për filologji në Klagenfurt (1923-1926), Grac (1927) dhe Vjenë të Austrisë (1930), ku ndoqi mësimet e Paul Kretschmer, Karl Patsch, Nikolai Trubetzkoy dhe Norbert Jokl.

Çabeji filloi të kishte interes të madh në zhvillimin historik të gjuhës shqipe. Në 1933, ai dorëzoi disertacionin e doktoraturës mbi Studime Italo-Shqiptare, në Vjenë. Çabeji u kthye në Shqipëri, ku edhe punoi si mësues gjimnazi në Shkodër (1934), Elbasan, Tiranë dhe Gjirokastrë. Pas fillimit të Luftës së Dytë Botërore, ai vajti në Romë, ku qëndroi deri në korrik të 1944-s. Atij iu ofrua posti i Ministrit të Kulturës në qeverinë kukull të Rexhep Mitrovicës, në vitin 1943, por ai e refuzoi, ai u kthye në Shqipëri në 1944. Në vitin 1947, ai u caktua anëtar i Institutit të Shkencave, instituti paraardhës i Universitetit të Tiranës. Nga 1952 deri më 1957, ai shërbeu si profesor i historisë së Shqipërisë dhe fonetikës historike. Në 1972, ai u bë anëtar themelues i Akademisë së Shkencave. Dëshira për t'u bërë sa më i vlefshëm për atdheun, e nxiti atë që, pas një viti qëndrimi në St. Pölten, vitin tjetër të merrte njëherësh dy klasa të gjimnazit, që e mbaroi shkëlqyeshëm në vitin 1926, në Klagenfurt të Austrisë. Këtu fillon faza kritike për

të ardhmen e këtij të riu të talentuar, i ati ishte një gjykatës i diplomuar në Dar - ul - Hukuk të Stambollit. I nisur nga dëshira që i biri të kishte një të ardhme të sigurt, e këshilloi të vazhonte universitetin për mjekësi, por, i biri kishte tjetër dëshirë. Ai në Universitetin e Vjenës donte të bëhej gjuhëtar. Në veprimtarinë gjysmëshekullore të Çabejit vendin kryesor e zë pa dyshim prodhimtaria e tij e pasur shkencore, e cila mund të ndahet në dy faza kryesore: faza e parë vazhdon deri në prag të çlirimit të Shqipërisë dhe faza e dytë nis pas vitit 1945. Veprimtaria e tij shkencore gjatë këtyre dy fazave është e kushtëzuar, jo vetëm nga interesat e tij shkencore, por edhe nga punët që ishte ngarkuar të kryente.

Studime gjuhësore

“Tekste italo-shqiptare”, (1935). “Elemente dialektore nga Italia”. “Marrëdhëniet midis shqipes dhe rumanishtes”. “Shprehje dhe frazeologji paralele në gjuhët ballkanike”.

Letërsia dhe folklori

‘Kënga e Leonorës në poezinë popullore shqiptare’, ‘Zakone dhe doke të shqiptarëve’, ‘Konstandini i vogëlth dhe kthimi i Odiseut’, ‘Për gjenezën e literaturës shqipe’, ‘Kulti dhe vijimi i hyjneshës Diana në Ballkan’.

Veprat

“Hyrje në Indoevropianistikë”; “Studime etimologjike në fushën e shqipes”, Tiranë, 1976, 1999; “Hyrja në historinë e gjuhës shqipe”, Tiranë, 1958; “Fonetika historike e shqipes”, Tiranë, 1968; “Shqipja në Kapërcyell”; “Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes”; “Meshari” i Gjon Buzukut, Tiranë, 1968; “Fjalor i gjuhës shqipe”, 1954.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mori pjesë në takimin e Këshillit të Punëve të Jashtme të Bashkimit Evropian me ministrat e Mbrojtjes të BE-së, më 28 maj 2024, për të diskutuar mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën dhe nevojën për të rritur prodhimin e mbrojtjes. NATO dhe Bashkimi Evropian kanë punuar shumë ngushtë së bashku për të ofruar mbështetje të paprecedentë ushtarake, ekonomike dhe financiare për Ukrainën. Stoltenberg theksoi nevojën për të rritur shpërndarjen e municioneve, sistemeve të mbrojtjes ajrore, dhe veçanërisht atyre më të avancuara, sistemeve “Patriot”.

Përpara Samitit të Uashingtonit, NATO po punon mbi planet për të koordinuar më tej sigurimin e pajisjeve dhe trajnimit, të mbështetur nga zotimi financiar. Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi nevojën për të “parandaluar boshllëqet dhe vonesat siç kemi parë kohët e fundit” dhe rëndësinë e ofrimit të “mbështetjes së parashikueshme dhe të përgjegjshme për një kohë të gjatë”, në mënyrë që Ukraina të mund të mbizotërojë si një komb sovran dhe i pavarur.

NATO po punon ngushtë me bazën industriale të mbrojtjes transatlantike për të rritur prodhimin, si për të mbështetur Ukrainën dhe për rezervat e aleatëve. “Që nga dita e parë e kësaj lufte, NATO dhe Bashkimi Evropian kanë punuar shumë ngushtë së bashku për të ofruar mbështetje të paprecedentë ushtarake, ekonomike dhe financiare për Ukrainën. Prandaj, është gjithmonë e dobishme të ulemi me ministrat dhe të diskutojmë se si të mbajmë mbështetjen tonë dhe të shtojmë atë që bëjmë. Nevoja më urgjente tani është më shumë mbrojtje ajrore dhe ne po punojmë me aleatët e NATO-s, dhe shumë prej tyre sigurisht edhe anëtarë të BE-së, për të rritur shpërndarjen e municioneve, sistemeve të mbrojtjes ajrore, dhe veçanërisht atyre më të avancuara, sistemeve “Patriot”. Pra, ne kemi parë një përparim. Por në Ukrainë nevojiten urgjentisht më shumë përparim dhe më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore”, - tha Stoltenberg.

Në fakt ky ishte edhe mesazhi i Këshillit NATO-Ukrainë, i cili u mbledh në të njëjtën ditë në NATO. Ndërkohë NATO po punon se si mund të koordinojë sigurimin e pajisjeve dhe trajnimit. “Ne kemi marrë një propozim nga Komandanti ynë Suprem i Aleatëve, SACEUR, se si ta organizojmë këtë. Pra, NATO koordinon mbështetjen e pajisjeve ushtarake dhe stërvitjes për Ukrainën. Unë kam propozuar gjithashtu një premtim financiar shumëvjeçar, që do të thotë se ne duhet të biem dakord si aleatë të NATO-s, një premtim financiar për Ukrainën gjatë disa viteve për të siguruar që ne të parandalojmë boshllëqet dhe vonesat, siç kemi parë kohët e fundit dhe që Ukraina të marrë mbështetje të parashikueshme dhe të përgjegjshme. për një kohë të gjatë dhe kjo është ajo që ata duhet të mbizotërojnë si një komb sovran i pavarur”, - tha Stoltenberg. “Së fundi, ne po punojmë edhe me industrinë për të rritur prodhimin. Kemi parë disa vendime të rëndësishme së fundmi për më shumë investime, më shumë prodhim. Por ne kemi nevojë për më shumë dhe po punojmë ngushtë me bazën industriale të mbrojtjes transatlantike për të rritur prodhimin”, - deklaroi Sekretari i Përgjithshëm.

Heqja e kufizimeve për armët perëndimore për të goditur objektivat brenda Rusisë

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg deklaroi se Rusia shkeli ligjin ndërkombëtar, duke sulmuar Ukrainën dhe se Kiev i ka të drejtën të vetëmbrohet dhe vendet e NATO-s kanë të drejtën ta ndihmojnë atë. Stoltenberg foli gjatë një deklarate të përbashkët për shtyp me kryeministrin e Bullgarisë, ku u mbajt sesiioni i pranverës i Asamblesë Parlamentare të NATO-s.

“Së pari mendoj se është e rëndësishme të mbani mend se çfarë është kjo. Kjo është një luftë agresioni. Rusia ka sulmuar, pushtuar një vend tjetër, duke shkelur ligjin ndërkombëtar, duke vrarë civilë dhe duke pushtuar pjesë të territorit ukrainas. Shkelja e kufijve të njohur ndërkombëtarisht, kufij të cilët fillimisht i njohu edhe Rusia. Pra, pushtimi rus i Ukrainës është një shkelje e hapur e ligjit ndërkombëtar. Sipas ligjit ndërkombëtar, Ukraina ka të drejtë të mbrohet. Vetë-mbrojtja është e përfshirë në Kartën e OKB-së, vetëmbrojtja është e përfshirë në të drejtën ndërkombëtare. Ukraina ka të drejtë të mbrohet kundër agresionit rus. Ne kemi të drejtën si aleatë të NATO-s për të ndihmuar Ukrainën të ruajë të drejtën e vetëmbrojtjes”, - tha ai.

Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu tha se qeveritë e vendeve të NATO-s, duhet të rishikojnë kufizimet që i kanë vendosur Ukrainës për përdorimin e armatimeve që i dërgojnë, ku disa nga aleatët i kanë hequr kufizimet, të tjerët jo. “U takon aleatëve të vendosin për kufizimet në armët që i dorëzojnë Ukrainës. Ky nuk është një vendim i NATO-s, është një vendim i marrë nga aleatët individualë. Aleatët individualë kanë marrë vendime të ndryshme. Disa aleatë nuk kanë kufizime, aleatë të tjerë kanë vendosur kufizime të ndryshme. Mesazhi im është se mendoj se ka ardhur koha për të shqyrtuar disa nga këto kufizime. Sepse ne duhet të kujtojmë se Ukraina ka të drejtën për vetëmbrojtje, ata po mbrojnë tokën e tyre, territorin e tyre. Dhe, sipas ligjit ndërkombëtar, e drejta për vetëmbrojtje përfshin të drejtën për të goditur objektiva legjitime ushtarake jashtë Ukrainës. Kjo është pjesë e vetëmbrojtjes. Dhe ne e shohim këtë të demonstruar shumë qartë tani në luftimet në Kharkiv, sepse ato janë në të vërtetë, forcat ruse janë në territorin rus, duke sulmuar pikërisht mbi kufirin, territorin ukrainas. Vija e frontit është pak a shumë vija e kufirit dhe nëse nuk mund të sulmohen forcat ruse në anën tjetër të vijës së frontit, sepse ato janë në anën tjetër të kufirit,

Jens Stoltenberg: Nevoja më urgjente e Ukrainës është më shumë mbrojtje ajrore



atëherë sigurisht që me të vërtetë zvogëlohet aftësia e forcave ukrainase për të mbrojtur veten. Sepse atëherë rusët thjesht mund të qëllojnë pa u sulmuar.

Sigurisht që do të jetë shumë e vështirë për ukrainasit të mbrohen nëse nuk mund të godasin objektivat ushtarake vetëm në anën tjetër të kufirit. Këto mund të jenë lëshues raketash. Mund të jetë artileri. Mund të jenë fusha ajrore që përdoren për të sulmuar Ukrainën dhe nëse Ukraina nuk mund t'i godasë ato objektiva ushtarake, do të jetë shumë më e vështirë për ta që të mbrohen”, - tha Stoltenberg.

Reagimi i tij vjen pasi Presidenti Zelenskyy u bëri thirrje aleatëve perëndimorë më 27 maj, gjatë një konference shtypi në Madrid, që ta lejojnë Ukrainën të godasë për vetëmbrojtje objektiva ushtarake brenda Rusisë me armët e dërguara prej tyre. Kremlini nga ana e tij tha se Perëndimi rrezikon një konfrontim të drejtpërdrejtë me Rusinë dhe një luftë globale në të ardhmen, nëse e lejon Ukrainën ta bëjë një gjë të tillë. Gjatë vizitës në Spanjë, Zelenskyy siguroi një marrëveshje prej 1 miliard euro ndihma ushtarake. Më 28 maj, Belgjika u bë vendi i dytë që premtoi një ndihmë të tillë brenda dy ditëve. Marrëveshja për ndihmën u nënshkrua nga Kryeministri belg Alexander De Croo dhe Presidentit Zelenskyy gjatë vizitës në Belgjikë. Marrëveshja parashikon edhe dërgimin e 30 avionëve luftarakë F-16 dhe Zelenskyy dhe De Croo vizituan një bazë ushtarake dhe inspektuan avionët F-16.

Mbështetja për Ukrainën dhe parandalimi i përshkallëzimit të luftës përtej Ukrainës

Ministrat e mbrojtjes të Bashkimit Evropian mbajtën takim në Bruksel, në përpjekje për të miratuar miliarda euro ndihmë ushtarake për Ukrainën, gjë që deri tani është penguar nga Hungaria. 6.5 miliardë euro ndihmë ushtarake nga BE-ja kanë ngecur për shkak të kundërshtimit të qeverisë hungareze.

Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO ka dy detyra në këtë luftë. Njëra është mbështetja për Ukrainën, për të siguruar që Ukraina të mbizotërojë dhe se NATO po e bën këtë duke ofruar trajnime të pajisjeve mbështetëse ushtarake dhe detyra tjetër është parandalimi që kjo luftë të përshkallëzohet përtej Ukrainës, të kthehet në një konflikt të plotë midis NATO-s dhe Rusisë. “Ne e bëjmë këtë pjesërisht, duke mos dërguar trupa të NATO-s. Ne nuk kemi ndonjë plan për të dërguar trupa luftarake të NATO-s në Ukrainë ose për t'u përfshirë drejtpërdrejt në luftë”, - tha Shefi i NATO-s. NATO gjithashtu po parandalon përshkallëzimin duke rritur praninë e saj ushtarake në pjesën lindore të Aleancës, dhe vendet baltike, në Rumani dhe Poloni, për të hequr çdo hapësirë për llogaritje të gabuara në Moskë për gatishmërinë për të mbrojtur të gjithë aleatët dhe duke parandaluar përshkallëzimin përtej Ukrainës.

“Fakti që ne po dërgojmë pajisje në Ukrainë nuk e bën NATO-n palë në konflikt. Ne kemi të drejtë të mbështesim Ukrainën pa u bërë palë në konflikt, sepse po e ndihmojmë Ukrainën të mbrojtë të drejtën për vetëmbrojtje. Disa aleatë nuk kanë vendosur kurrë kufizime se si të përdorin armët që i ofrohen Ukrainës. Dhe në fakt, kur ata i dorëzuan armët në Ukrainë, ato janë armë ukrainase. Përsëri, këto janë vendime kombëtare. Janë bërë konsiderata të ndryshme. Por unë besoj fort se ata aleatë që kanë vendosur të mos kenë kufizime, ata nuk e bëjnë NATO-n palë në konflikt dhe kjo sigurisht do të jetë edhe për aleatët e tjerë”, - theksoi edhe para takimit të ministrave të Mbrojtjes të BE-së Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm tha se ndërkohë NATO ka parë rritje të aktivitetit të inteligjencës ruse në të gjithë Aleancën. “Prandaj kemi rritur vigjilencën tonë. Ne kemi shërbimet tona që po monitorojnë nga afër se çfarë po bëjnë rusët. Dhe është

e rëndësishme që edhe kombet të ndërmarrin veprime për arrestimet dhe proceset ligjore që kanë filluar tani në MB, në Gjermani, në Poloni dhe në vende të tjera. Thjesht tregon se duhet të jemi të përgatitur. Duhet të jemi gati dhe ne duhet të ndajmë inteligjencën. Ne duhet të shkëmbejmë informacione për t'iu kundërvënë këtyre llojeve të ndryshme të aktiviteteve hibride, që synojnë të minojnë aftësinë e aleatëve të NATO-s për të ofruar mbështetje për Ukrainën”, - tha ai, “tregon gjithashtu se sa serioze është situata dhe sa e rëndësishme është që ne të vazhdojmë të kemi një Aleancë të fortë të NATO-s që të pengojë një sulm ushtarak kundër aleatëve të NATO-s”.

Ndërsa u pyet lidhur me zërat se Putini kërkon negociata për paqe, Sekretari i Përgjithshëm tha se: “kjo luftë mund të përfundojë nesër nëse qeveria, vendi që filloi luftën, presidenti Putin ndalon të sulmojë Ukrainën. Sfida është se ne nuk shohim shenja se Presidenti Putin, Rusia po planifikon t'i japë fund kësaj lufte. Përkundrazi, ne po shohim që ata po rriten”, - vërejtji Stoltenberg. “U takon ukrainasve të vendosin se cilat janë kushtet e pranueshme për një marrëveshje. Ajo që ne dimë si aleatë të NATO-s është se ajo që ndodh rreth tryezës së bisedimeve është e lidhur ngushtë me fuqinë në fushën e betejës. Pra, nëse duam një zgjidhje të negociuar ku Rusia pranon që Ukraina duhet të mbizotërojë si një komb sovran i pavarur në Evropë, atëherë e vetmja mënyrë për të arritur atje është t'i japim mbështetje ushtarake Ukrainës në mënyrë që ata të mund t'i demonstrojnë Presidentit Putin se ai nuk do të fitojë në fushën e betejës. Ai nuk do të marrë kontrollin mbi Ukrainën, duke përdorur forcën ushtarake, por duhet të ulet dhe të pranojë Ukrainën sovranë të pavarur edhe në të ardhmen”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Mbrojtja ajrore aleate, komplekse raketash përgjatë bregut bullgar të Detit të Zi

Në takimin me kryeministrin bullgar Dimitar Glavchev, në ditën e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, Stoltenberg falënderoi për “rolin kritik të Bullgarisë në ruajtjen e sigurisë së Detit të Zi, Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë”, duke përfshirë kontributin në misionin paqeruajtës të NATO-s, KFOR në Kosovë, misionin e trajnimit të Aleancës në Irak dhe duke pritur një nga tetë grupet luftarake shumëkombëshe të NATO-s që ndihmon në frenimin e agresionit rus. Ai vlerësoi më tej Bullgarinë për rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes me gati 20% vitin e kaluar dhe për përmbushjen e udhëzimit për shpenzimin e 2% të PBB-së për mbrojtjen në vitin 2024. “Bullgaria është një anëtare e besueshme e Aleancës që ndihmon në forcimin e mbrojtjes sonë kolektive”, - tha Stoltenberg. “Ne kurrë nuk mund ta marrim si të mirëqenë lirinë apo sigurinë tonë. Kjo është arsyeja pse, në të gjithë Aleancën, ne po rrisim prodhimin e armëve dhe municioneve. Kjo është arsyeja pse NATO po forcon përgjigjen e saj ndaj veprimeve armiqësore të Rusisë që synojnë infrastrukturën tonë kritike dhe proceset demokratike dhe pse ne po planifikojmë që NATO të luajë një rol më të madh në koordinimin e ndihmës dhe trajnimit të sigurisë për Ukrainën”. Në javët e fundit, aleatët kanë bërë premtime të reja të mëdha mbështetjeje për Ukrainën, premtime që do të bëjnë ndryshimin. Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO ka rritur praninë në rajonin e Detit të Zi. “Ne kemi policim ajror, kemi grupe luftarake, edhe tani në Rumani dhe Bullgari dhe sigurisht kjo rritet, ne gjithashtu kemi rritur vigjilencën tonë. Ne kemi më shumë aftësi zbulimi dhe e gjithë kjo na ndihmon të monitorojmë, ndjekim më nga afër atë që bën Rusia dhe gjithashtu të jemi në gjendje të përgjigjemi nëse shohim ndonjë nivel të rritur kërcënimi”. Ai tha se NATO nuk sheh ndonjë kërcënim të afërt të një sulmi të armatosur kundër ndonjë aleati të saj, por që “sigurisht me një luftë që po vazhdon në Ukrainë, me gjithë paqëndrueshmërinë në Detin e Zi, ka qenë e nevojshme të rrisim vigjilencën tonë për të rritur praninë tonë si në tokë, edhe në ajër, për të siguruar që ne jemi në gjendje të reagojmë nëse ka nevojë për të rritur më tej praninë tonë”, - tha Stoltenberg.

“NATO po investon më shumë në mbrojtjen e integruar ajrore dhe raketore për të rritur aftësinë e saj, për të përforcuar shpejt, për të vendosur aftësitë e nevojshme, ndërkohë që ajo është shumë vigjilente dhe do të vazhdojmë të monitorojmë situatën në Detin e Zi”, - tha Stoltenberg. “Ne nuk duam një konflikt në shkallë të plotë midis Rusisë dhe NATO-s. NATO nuk kërkon konflikt me Rusinë. Dhe fakti që ne po mbështesim Ukrainën nuk e bën NATO-n dhe aleatët e NATO-s palë në konflikt. Prandaj, ne nuk kemi plane për dislokimin e trupave të NATO-s në Ukrainë ose dërgimin e kapaciteteve ajrore të NATO-s në hapësirën ajrore të Ukrainës, por ne po ofrojmë mbështetje kritike për Ukrainën në mënyrë që ata të mund të mbrohen”, - ritheksoi ai.

8 luftërat më vdekjeprurëse të shekullit të 21-të

Teoricieni politik Francis Fukuyama shpalli në mënyrë të bujshme se fundi i Luftës së Ftohtë shënoi “fundin e historisë”, një triumf i demokracisë perëndimore kapitaliste, liberale mbi ideologjitë konkurruese. Besohej se njerëzimi i shekullit të 21-të do të ishte një shoqëri e globalizuar pas konfliktit që do të lëvizte në një koncert determinist drejt paqes dhe prosperitetit kolektiv. Ndërsa teza e Fukuyama u sfidua thellësisht nga sulmet e 11 shtatorit 2001 dhe “lufta kundër terrorizmit” pasuese e SHBA-së, lufta e hapur midis ushtrive të shteteve-kombe, në fakt, u bë gjithnjë e më e rrallë në mjedisin e pas Luftës së Ftohtë. Në vend të kësaj, terrorizmi, konflikti etnik, luftërat civile dhe lufta hibride dhe operacione speciale (teknika të përdorura nga vendet e zhvilluara për të ngacmuar ose destabilizuar kundërshtarët përmes mjeteve jo tradicionale) përbënin pjesën më të madhe të dhunës jo shtetërore dhe ndërshtetërore. Edhe pse shekulli i 21-të ka parë një ulje të konsiderueshme të shkallës së vdekjeve nga beteja kur krahasohet me periudha të ngjashme kohore në shekullin e kaluar, megjithatë këto shifra përfaqësojnë dhjetëra mijëra jetë të humbura çdo vit.

Lufta e Dytë e Kongos (1998–2003)

Lufta më vdekjeprurëse e shekullit të 21-të ishte një konflikt që e pati zanafillën në shekullin e 20-të. Gjenocidi i Ruandës, përmbysja dhe vdekja e Presidentit Zairean Mobutu Sese Seko dhe grindjet etnike midis popujve Hutu dhe Tutsi ishin faktorë kontribuues të drejtpërdrejtë në Luftën e Dytë të Kongos (e quajtur edhe Lufta e Madhe në Afrikë ose Lufta e Parë Botërore e Afrikës për shkak të shtrirjes së saj dhe pasojave shkatërruese). Në maj 1997, udhëheqësi rebel Laurent Kabila rrëzoi Mobutu dhe e quajti Zaire Republika Demokratike e Kongos (DRC), por ai shpejt e gjeti veten të përfshirë në një luftë civile me disa nga forcat që e kishin ngritur atë në pushtet. Pjesa lindore e DRC u bë një fushë beteje po aq e përgjakshme dhe e kontestuar sa Fronti Perëndimor në Luftën e Parë Botërore. Ushtritë e nëntë vendeve dhe një sërë milicish të lidhur shkatërruan fshatin. Angola, Namibia, Çadi, Sudani dhe Zimbabveja mbështetën forcat qeveritare kongoleze të Kabilës, ndërsa trupat nga Burundi, Ruanda dhe Uganda mbështetën rebelët anti-Kabila. Përdhunime masive u raportuan në zonat e konfliktit dhe pjesë të mëdha të DRC-së iu hoqën burimet, pasi luftimet e organizuara midis ushtrive profesionale ia lanë vendin plaçkitjes. Rreth tre milionë njerëz - kryesisht civilë - u vranë në luftime ose vdiqën nga sëmundjet ose kequshqyerja si rezultat i konfliktit.

Lufta Civile Siriane

Ndërsa Pranvera Arabe përfshiu Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, kryengritjet popullore rrëzuan regjimet autoritare në Tunizi, Libi, Egjipt dhe Jemen. Në Siri, megjithatë, presidenti Bashar al-Assad iu përgjigj protestave me një kombinim të lëshimeve politike dhe përshkallëzimit të dhunës kundër popullit të tij. Kryengritja u bë një luftë civile që përhapi dhunën në Irakun fqinj dhe siguroi një terren pjellor për grupe militante si Shteti Islamik në Irak dhe Levant (ISIL; i njohur gjithashtu si ISIS). Grupet rebele kapën zona të mëdha territori dhe zona nën kontrollin e qeverisë u reduktua në një rrip të vogël toke në Sirinë perëndimore. Assad iu drejtua masave gjithnjë e më të dëshpëruara dhe të egra për të ruajtur pushtetin, duke hedhur “bomba me fuçi” të papërpunuara mbi popullsinë urbane dhe duke përdorur armë kimike në territorin e kontrolluar nga rebelët. Ndërsa fuqitë rajonale dhe vendet perëndimore morën një rol më të madh në konflikt, dukej e pashmangshme që Assadi të largohej nga pushteti. Milicët kurde përparuan nga rajoni autonom kurd në Irakun verior dhe SHBA-të kryen sulme ajrore kundër forcave të ISIL si në Siri ashtu edhe në Irak. Në vitin 2015 Rusia, një mbështetëse e gjatë e regjimit të Asadit, filloi një fushatë bombardimi në mbështetje të forcave qeveritare siriane që përmbysën valën e luftës. Marrëveshjet e armëpushimit nuk arritën të ndalonin dhunën dhe deri në vitin 2016 u vlerësua se 1 në 10 sirianë ishte vrarë ose plagosur nga luftimet. Katër milionë njerëz u larguan nga vendi, ndërsa miliona të tjerë u zhvendosën brenda vendit. Të paktën 470 000 vdekje u shkaktuan drejtpërdrejt ose tërthorazi nga lufta, dhe jetëgjatësia në lindje përjetoi një rënie tronditëse nga më shumë se 70 vjet (para konfliktit) në vetëm 55 vjet në 2015. Në vitin 2022 Kombet e Bashkuara vlerësuan se luftimet kishin prekur jetët e më shumë se 300 000 civilëve, rreth 1.5 për qind e popullsisë së Sirisë para luftës.

Konflikti i Darfurit

Në fillim të vitit 2003 grupet rebele morën armët kundër regjimit me bazë në Khartoum të presidentit sudanez Omar al-Bashir, duke ndezur tensione të gjata në rajonin Darfur të Sudanit perëndimor. Ai konflikt shpërtheu në atë që qeveria amerikane e përshkroi më vonë si gjenocidin e parë të shekullit të 21-të. Pasi grupet rebele shënuan një varg fitimesh të profillit të lartë kundër ushtrisë sudaneze, qeveria sudaneze pajisi dhe mbështeti milicët arabe që u quajtën Janjaweed. Janjaweed kreu një fushatë të synuar të terrorizmit dhe spastrimit etnik kundër popullsisë civile të Darfurit, duke vrarë të paktën 300 000 njerëz dhe duke zhvendosur gati tre milionë. Vetëm në vitin 2008, një forcë e përbashkët paqeruajtëse e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Afrikan ishte në gjendje të rivendoste një pamje të rendit në rajon. Më 4 mars 2009, Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC) lëshoi një urdhër-arresti për Bashirin – hera e parë që ICC kërkoi arrestimin e një kreu të shtetit në detyrë – duke e akuzuar atë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ky hetim u pezullua në dhjetor 2014 për shkak të mungesës së bashkëpunimit nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.

Lufta e Irakut

Zyrtarët neokonservatorë brenda administratës së presidentit amerikan George W. Bush kishin kërkuar të rrëzonin regjimin e



presidentit irakian Saddam Hussein përpara ngjarjeve të 11 shtatorit 2001, por sulmi terrorist më vdekjeprurës në historinë e SHBA-së do të siguronte (të paktën pjesërisht) ‘casus belli’ për Luftën e Irakut. Duke përmendur lidhjet midis regjimit irakian dhe al-Kaedës, si dhe praninë në Irak të armëve të shkatërrimit në masë - të dyja pretendimet që përfundimisht u provuan të rreme - SHBA mbloodhi një “koalicion të vullnetarëve” dhe filloi një sulm në Irak më 20 mars 2003. Lufta e mëvonshme u shpalo në dy faza të dallueshme: një luftë e shkurtër konvencionale e njëanshme, në të cilën forcat e koalicionit pësuan më pak se 200 viktima në pak më shumë se një muaj të operacioneve të mëdha luftarake dhe një kryengritje që vazhdoi për vite dhe mori dhjetëra mijëra jetë. Në kohën kur forcat luftarake të SHBA-së u tërhoqën në gusht 2010, më shumë se 4 700 trupa të koalicionit ishin vrarë; të paktën 85 000 civilë irakianë ishin vrarë gjithashtu, por disa vlerësime e vendosin atë shumë më të lartë. Dhuna sektare që shkatërroi vendin pas përmbysjes së regjimit ba’athist të Huseinit i dha lindjen e Shtetit Islamik në Irak dhe Levant (ISIL; i quajtur gjithashtu ISIS), një grup sunit që kërkoi të krijonte një kalifat në Irak dhe Siri. Midis 2013 dhe fundit të 2016, më shumë se 50 000 civilë të tjerë u vranë nga ISIL ose u vranë në përleshjet midis ISIL dhe forcave qeveritare irakiane.

Lufta e Afganistanit

Brenda disa javësh nga sulmet e 11 shtatorit 2001, Shtetet e Bashkuara filluan të kryejnë sulme ajrore kundër regjimit taleban në Afganistan. Talibanët, një fraksion ultrakonservator islamik që mori pushtetin në vakumin e mbetur pas tërheqjes sovjetike nga Afganistani, siguroi një strehë të sigurt për al-Kaedën dhe udhëheqësin e saj, Osama bin Laden. Lufta në Afganistan u bë, për njëfarë kohe, manifestimi më i dukshëm i “luftës kundër terrorizmit” të udhëhequr nga SHBA-të. Deri në dhjetor 2001, talebanët ishin detyruar të largoheshin nga pushteti, por si talebanët afganë dhe homologu i tij pakistanez do të rimerrte forcën në zonat fisnore që shtrihen në kufirin e këtyre dy vendeve. Duke rishikuar taktikat e tij për të pasqyruar ato të përdorura nga kryengritësit në Irak, talebanët filluan të përdorin pajisje shpërthyes të improvizuara (IED) në objektiva ushtarakë dhe civilë, me një efekt të madh. Talebanët nxitën kultivimin e lulëkuqes në zonat nën kontrollin e tyre dhe tregtia ndërkombëtare e opiumit financoi shumë nga aktivitetet e saj ushtarake dhe terroriste. Ndërmjet viteve 2001 dhe 2016 u vranë rreth 30 000 trupa dhe policë afganë dhe 31 000 civilë afganë. Më shumë se 3 500 trupa nga koalicioni i udhëhequr nga NATO u vranë gjatë asaj kohe dhe 29 vende u përfaqësuan në mesin e të vdekurve. Përveç kësaj, rreth 30 000 forca të qeverisë pakistaneze dhe civilë u vranë nga talebanët pakistanezë.

Lufta kundër Boko Haram

Grupi militant islamik Boko Haram (një emër që do të thotë “perëndimizimi është sakrilegj” në gjuhën Hausa) u themelua në vitin 2002 me qëllimin e imponimit të sheriatit (ligjit islamik) në Nigeri. Grupi ishte relativisht i errët deri në vitin 2009, kur nisi një seri bastisjesh që vranë dhjetëra oficerë policie. Qeveria nigeriane u hakmor me një operacion ushtarak që la të vdekur më shumë se 700 anëtarë të Boko Haram. Policia dhe ushtria nigeriane më pas kryen një fushatë vrasjesh pa gjyq që ndezi atë që kishte mbetur nga Boko Haram. Duke filluar në vitin 2010, Boko Haram u kundërpërgjigj,

duke vrarë oficerët e policisë, duke organizuar burgosje dhe duke sulmuar objektiva civilë në të gjithë Nigerinë. Shkollat dhe kishat e krishtera në verilindje të vendit u goditën veçanërisht rëndë dhe rrëmbimi i gati 300 nxënëseve në vitin 2014 tërhoqi dënimin ndërkombëtar. Ndërsa Boko Haram filloi të kontrollonte më shumë territore, karakteri i konfliktit u zhvendos nga një fushatë terroriste në një kryengritje të plotë që kujtoi Luftën e Përgjakshme Civile Nigeriane. Qytete të tëra u shkatërruan në sulmet e Boko Haram dhe trupat nga Kameruni, Çadi, Benini dhe Nigeri përfundimisht iu bashkuan përgjigjes ushtarake. Megjithëse zona nën kontrollin e Boko Haram ishte gërryer ndjeshëm deri në fund të vitit 2016, grupi ruante ende aftësinë për të kryer sulme vetëvrasëse vdekjeprurëse. Të paktën 11 000 civilë u vranë nga Boko Haram dhe më shumë se dy milionë njerëz u zhvendosën nga dhuna.

Lufta Civile e Jemenit

Lufta civile në Jemen e pati zanafillën e saj në Pranverën Arabe dhe kryengritjen që rrëzoi qeverinë e Ali Abdullah Saleh. Ndërsa Saleh përpigëj të mbante kontrollin e tij në presidencën, ai kujtoi ushtrinë nga zonat periferike në Sanaa, kryeqyteti i Jemenit. Rebelët Houthi në veri të vendit dhe militantët e Al-Kaedës në Gadishullin Arabik (AQAP) në jug e shfrytëzonin shpejt vakumin e pushtetit. Luftimet midis forcave qeveritare dhe milicive fisnore të opozitës u intensifikuan dhe më 3 qershor 2011, Saleh ishte objektiv i një atentati që e la të plagosur rëndë. Saleh u largua nga Jemeni për të marrë trajtim mjekësor, një lëvizje që përfundimisht çoi në transferimin e pushtetit te zëvendës-presidenti i Saleh, Abd Rabbuh Mansur Hadi. Hadi nuk arriti të rivendoste një prani efektive të qeverisë në rajonet nën kontrollin e Houthi dhe AQAP, dhe përgjigja e tij e dhunshme ndaj protestave në Sanaa ngjalli simpati për kauzën antiqeveritare. Në shtator 2014, rebelët Houthi hynë në Sanaa dhe deri në janar 2015 ata kishin pushtuar pallatin presidencial. Hadi u vendos në arrest shtëpiak, por ai u arratis dhe u arratis në qytetin port jugperëndimor të Adenit. Një forcë e përbërë nga Houthi dhe trupa besnike të Salehit të rrëzuar më pas rrethoi Adenin dhe Hadi u largua nga vendi në mars 2015. Atë muaj konflikti u ndërkombëtarizua kur një koalicion i udhëhequr nga Arabia Saudite u zhvendos për të larguar Houthit nga pushteti dhe për t’u rivendosur Qeveria Hadi. Besohej gjerësisht se Irani po ofronte mbështetje materiale për Houthis, dhe dërgesa të shumta armësh nga Irani u kapën gjatë rrugës për në zonën e konfliktit. Deri në fund të vitit 2021, Kombet e Bashkuara vlerësuan se më shumë se 375 000 jetë ishin humbur si rezultat i luftës; Shkaqet indirekte, si uria dhe sëmundjet lehtësisht të shërueshme, ishin përgjegjëse për më shumë se gjysmën e këtij totali. Përveç kësaj, më shumë se tre milionë jemenas ishin zhvendosur nga lufta.

Lufta Rusi-Ukrainë

Në shkurt të vitit 2014, presidenti pro-rus i Ukrainës, Viktor Janukoviç, u rrëzua nga pushteti pas muajsh demonstratash popullore dhe një goditjeje të dhunshme të dështuar ndaj protestuesve. Yanukovych iku në Rusi dhe, brenda disa ditësh nga largimi i tij, trupat ruse të maskuara pushtuan republikën autonome ukrainase të Krimesë. Presidenti rus Vladimir Putin njoftoi aneksimin e paligjshëm të Krimesë në mars, dhe javë më vonë trupat ruse të maskuara pushtuan rajonet ukrainase të Donetsk dhe Luhansk. Në fillim të verës së vitit 2014, forcat pro-ruse kishin pushtuar një pjesë të konsiderueshme të territorit dhe në korrik, fluturimi MH17 i “Malaysia Airlines” u rrëzua mbi territorin e kontrolluar nga rebelët nga një raketë tokë-ajër e furnizuar nga Rusia. Rreth 300 pasagjerë dhe ekipazhi u vranë. Një armëpushim u nënshkrua në shkurt 2015, që ngadalësoi por nuk ndaloi gjakderdhjen dhe Donbasi mbeti në një gjendje konflikti të ngrirë për shtatë vitet e ardhshme. Deri në vitin 2021 më shumë se 14 000 njerëz ishin vrarë në luftimet në Ukrainën lindore.

Më 24 shkurt 2022, Rusia filloi një pushtim të plotë të Ukrainës. Megjithëse forcat ruse arritën përfitime të konsiderueshme në ditët e para të luftimit, mbrojtësit ukrainas kundërshtuan përpjekjet për të kapur Kievin dhe qytetet e tjera të mëdha dhe së shpejti po nishin kundërsulme në pozicionet ruse. Pushtimi rus u karakterizua nga bombardime pa dallim artilerie dhe sulme ajrore në qytetet e Ukrainës, dhe të paktën 40 000 civilë ukrainas u vranë në luftime. Ndoshta 200 000 trupa ukrainase u vranë në luftime dhe më shumë se një e treta e popullsisë së Ukrainës u zhvendos nga luftimet. Rusia kreu gjithashtu një fushatë spastrimi etnik në territorin që ajo pushtoi, dhe rreth 1.6 milionë qytetarë ukrainas u transferuan me forcë në territorin rus. Putini kishte shpresuar të përfundonte pushtimin e Ukrainës brenda pak ditësh, por, pas dy vitesh luftimesh, rreth 340,000 trupa ruse ishin vrarë ose plagosur dhe aftësia ushtarake konvencionale e Rusisë ishte degraduar ndjeshëm.

Jetët tona në epokën e inteligjencës artificiale

A sistentë robotë, makina vetë-drejtuese, syze inteligjente: si do të duket jeta jonë pasi inteligjenca artificiale të bëhet vërtet pjesë e jetës sonë të përditshme? A do të jetë një bekim apo një mallkim? Zhvillimet në AI gjatë dy viteve të fundit janë shkak për festime dhe shqetësim, pasi industria po ecën përpara pa rregullore të mjaftueshme. Nisja e ChatGPT ka vënë në duart tona një mjet të fuqishëm të AI-së dhe shumica prej nesh nuk e prisnin kurrë që ai të ishte kaq i avancuar. Ajo ngre një sërë shqetësimesh etike, si dhe mundësinë shumë reale që robotët së shpejti do të marrin përsipër punët tona. Në të njëjtën kohë, AI-ja mund të përdoret për përparime të mahnitshme në mjekësi, teknologji dhe arsim, duke përmirësuar cilësinë e jetës sonë.



Makina vetëdrejtuese

Këto automjete autonome do të jenë në gjendje të udhëtojnë me zero ndërhyrje të drejtpërdrejtë njerëzore, duke krijuar potencialisht më shumë nevojë për udhëtim dhe transport, por paradoksisht më pak nevojë për shoferë.

Syze

“Google Glass” u ndërpre në vitin 2017, por në vitin 2019 kompania shpalli “Google Glass Enterprise Edition 2”. Me syzet e tij inteligjente, Google dëshiron të na ndihmojë të marrim vendimet e duhura dhe të shmangim rreziqet.



Asistentë

Siri dhe Google Assistant tashmë na mundësojnë përgjigje të menjëhershme për një shumëllojshmëri të madhe pyetjesh. Ata janë gjithashtu në gjendje të kryejnë detyra në pajisjet tona teknologjike në vendin tonë.



Robotë?

Me veshjen e tyre të bërë që t'i ngjajë sa më shumë indit të lëkurës njerëzore dhe karakteristikave të tjera unike njerëzore, a mund të shohim një kohë në të ardhmen kur do t'i ngatërrojmë robotët me njerëzit dhe anasjelltas?


Mace dhe qen

Ju kujtohet Aibo, qeni robot i shpikur nga Sony? Pasardhësit e tij mund të bëhen të njohur në mesin e adhuruesve të kafshëve shtëpiake, kryesisht atyre që nuk kujdesen shumë për anëtarë negativë të posedimit të një të tillë.



MRI


Edhe në kujdesin shëndetësor, pritet shumë nga AI-ja. Për shembull, mund të na ndihmojë të zbulojmë kancerin me më shumë



saktësi sesa syri i njeriut, duke përdorur teknologjinë MRI.

Faturat

Kush do t'i thoshte jo, ndihmës me gjithë burokracinë dhe administrimin e tyre? Qoftë personale apo biznesi, inteligjenca



artificiale potencialisht mund të japë një dorë të madhe në këtë fushë. Për shembull, duke paguar faturat dhe/ose taksat për ju, pas së cilës do të merrni një njoftim.

Telefonat inteligjentë

Inteligjenca artificiale në telefonat inteligjentë do të përfshinte përfundimin e automatizuar të detyrave, identifikimin e përdoruesve të papërshtueshëm nga uji, njohjen e emocioneve, kuptimin e mënyrës se si flasim dhe, natyrisht, realitetin e shtuar.

Realiteti virtual

Prisni që mjetet me të cilat ruajmë informacionin tonë virtual të bëhen gjithnjë e më të vogla. Cloud computing do të bëhet gjithnjë e më e zakonshme dhe bota fizike do të bëhet gjithnjë e më pak e dobishme.



Orë shëndetësore

Versionet e reja të orëve inteligjente, të përmirësuara nga AI-ja, do të na ndihmojnë të marrim vendime më të mira në lidhje me shëndetin tonë bazuar në kritere që mund ta kemi të vështirë t'i masim me saktësi vetë, si rrahjet e zemrës dhe gjaku.

Shtëpi inteligjente

Termostatët e pajisur me inteligjencë artificiale do të jenë në gjendje të rregullojnë temperaturën e dhomës bazuar në numrin e entiteteve të pranishme dhe secilin prej zakoneve të tyre.

Fabrikat

Në fabrika, robotët me inteligjencë artificiale mund të fillojnë të shfaqen gjithnjë e më shumë, duke kryer detyra gjithnjë e më komplekse.

Kriptoalutat

Avantazhi i madh i kriptomonedhës është se decentralizon fluksin

e parave. Me pak inteligjencë artificiale të hedhur në përzjerje, institucionet e centralizuara si bankat kombëtare mund të mos kenë më kurrë ndonjë pushtet mbi furnizimin monetar të botës!

Inteligjenca Artificiale

Aktualisht, kompjuterët ekzekutojnë detyra bazuar në komanda dhe kode. Inteligjenca artificiale do të synojë të mësojë kompjuterët të mendojnë vetë, duke përdorur si model procesin e të mësuarit njerëzor.

Zgjedhje

Një aksident në të cilin një makinë vetëdrejtuese goditi dhe vrau një këmbësor ka sjellë në plan të parë pyetje serioze etike. Për shembull, a duhet të sakrifikojnë makinat vetë-drejtuese pasagjerët e tyre për të mos goditur këmbësorët, apo siguria e pasagjerëve duhet të jetë e para?

Logjikë e ftohtë

Disa thonë se AI-ja do të ishte në gjendje të vepronte sipas “logjikës së ftohtë” dhe vetëm kaq. Megjithatë, të tjerë thonë se kjo “logjikë” është ende fryt i mendimit njerëzor dhe për këtë arsye po aq i prekshëm ndaj grackave të paragjyqimeve njerëzore.

Përgjegjshmëri

Është vërtetuar se njerëzit kanë një tendencë për ta konsideruar njohurinë e makinës më të lartë se të tyre. E nënkuptuar në këtë besim, megjithatë, duket se është heqja e përgjegjësisë personale, e cila është themelore për të drejtat tona, detyrat dhe liritë tona si qytetarë.

Të mësuarit e thellë

Të mësuarit e thellë është një metodë e të mësuarit me makinë për robotët që është potencialisht e pafund. Megjithatë, disa thonë se duhet të ketë kufij. Në momentin që një robot mëson gjithçka nga ndërmjetësit e tij (njerëzor), ai gjithashtu do të ndikohet nga tiparet më pak të admirueshme të njerëzimit, argumentojnë ata.

Art

Një tjetër zhvillim interesant është se tani ekziston një robot që është një artist i bonifikuar. Ai-Da u krijua në MB dhe u publikua në vitin 2019. Ajo është në gjendje të krijojë art pamor me krahun e saj të pikturës dhe të komunikojë për punën e saj. Ajo ka pasur ekspozita të krijimeve të saj mbresëlënëse në mbarë botën. Ai-Da dhe AI të tjera me aftësi krijuese sjellin pyetje ekzistenciale për vetë natyrën e artit.



“Një popull që harron të kaluarën, humbet dhe të ardhmen e tij”

81 vite më parë, në kohën e pushtimit fashist, gjashtëdhjetë e tetë vajza nga qyteti i Fierit, më 14 shtator 1943, u hodhën në ilegalitet dhe dolën partizane. Kjo çetë luftëtaresh të reja dilte nga një qytet i vogël, që atëherë nuk i kalonte 5-6 mijë banorë. Një rast ky unikal në Shqipëri dhe pse jo edhe përtej saj, në Europën e pushtuar nga nazifashistët. S’kishte kushtim më të fuqishëm për luftë se sa ky akt madhështor i këtyre vajzave të reja. Vajza këto, nga të gjitha lagjet e qytetit dhe nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Studente e nxënëse, punëtore e më shumë shtëpiake, bija familjesh të varfra, po dhe atyre të kamura. Të frymëzuara nga ideali i shenjtë i lirisë, ato u ngritën mbi pengesat e rreziqet e panumërta, mbi mentalitetin dhe zakonet konservatore dhe niseshin në luftë për çlirimin e atdheut të robëruar. Me një atdhetarizëm të paparë, me një vetëdije të paparë, me një guxim dhe besim të paparë. Pjesë e kësaj mrekullie kombëtare ishte dhe akti sublim i këtyre vajzave shqiptare.

Natyrisht, ky akt nuk ndodhi rastësisht dhe nuk ishte ndonjë aventurë rinore. Për afro dy vjet, në atmosferën e pushtimit, ato do të mëkoheshin e mbruheshin me idetë e luftës, që përhapnin e përcillnin militantët e saj, do të merrnin pjesë në demonstrata e aksione, do të frekuentonin mbledhjet ilegale, do të shpërndanin trakte, do të mësonin të përdornin armët, do të ndihmonin njësitet guerile, do të ndiqnin kurse sanitare, do të qëndisnin flamurë dhe yje. Pa këtë përvojë dhe përgatitje nuk do ta hidhnin atë hap të guximshëm drejt luftës që i priste.

Dhe erdhi dita, ajo ditë e paharruar vjeshte, kur këto vajza dolën fshehurazi nga shtëpitë e tyre, kaluan nëpër rrugicat e ngushta, kapërcyen ujërat e Gjanicës dhe u mbledhën në një bazë ilegale në lagjen e varfër të Shkozës. Pastaj, sipas një plani të mirë përgatitur, të udhëhequra nga shokët e njësiteve guerile, dolën nga qyteti në orët e vona të pasdites dhe duke u fshehur pas kallamishteve të kënetës së Sheqit, u drejtuan për në zonat e çliruara nga partizanët. Merret me mend se ç’ ndodhte në mendjen e në shpirtin e këtyre vajzave të reja tek shkonin drejt një jete krejt të panjohur. Për disa ditë, ato do të ecnin në këmbë nëpër një itinerar me rrugë e pa rrugë, nga fshati Kallm i Myzeqesë në Dumre dhe prej këndeje në Kuçovë, për të mbërritur në Beratin e lirë përkohësisht. Një udhë e gjatë, e vështirë, e lodhshme, plot rreziqe, por që ato e kaluan me sukses të plotë. Ishte kjo prova e parë e këtyre vajzave të reja, shumë prej të cilave s’kishin kapërcyer ndonjëherë kufijtë e vendlindjes, por që nga gjithë ç’po ndodhte po kuptonin se atdheu i tyre nuk ishte vetëm qyteti i tyre, që kishte lënë pas, por tërë fushat dhe malet e Shqipërisë.

Dhe këtë do ta kuptonin më mirë, kur udhëheqës të luftës do t’i prisnin krahëhapur në Berat, do të bisedonin me to dhe do t’u flisnin për misionin që kishin përpara. Pas disa ditësh pushimi, atyre do t’u caktoheshin detyrat sipas aftësive dhe përgatitjes së secilës, duke u shpërndarë nëpër formacionet partizane si në Batalionin e sapokrijuar të rinisë “Margarita Tutulani” dhe Batalionet “Ismail Klosi”, “Petro Sota”, “Semani”. Ndërsa të tjerat u ngarkuan me detyra në terren, duke u dërguar nëpër fshatrat e Myzeqesë, të Mallakastrës dhe të Skraparit. Po nisnin kështu një jetë krejt të re, larg familjes dhe vendlindjes, po shkonin drejt së panjohurës, sa joshëse aq dhe enigmatike, po asnjëra prej tyre nuk mendonte për kthim prapa. Ishin ideali dhe morali partizan që i jepnin kuptim dhe e udhëhiqnin jetën e tyre tani e tutje.

Ky ishte vetëm fillimi, sepse më vonë, pas pagëzimit luftarak nëpër aksione të ndryshme dhe provave që dhanë, shumë prej tyre u radhitën në formacionet e lavdishme partizane si Brigada I dhe Brigadat V, VI, VII dhe XI. Ato vajza të brishta, hiret e të cilave përzhiteshin nga tymi i barutit, do të merrnin pjesë nëpër betejat e njohura të Tendës së Qypit, të Kalasë së Margëlliçit etj. Do të përballeshin me operacionin e egër të dimrit 1943-1944, duke provuar urinë dhe ngricat, plagët dhe lodhjen, duke u gjendur në situata nga më të rrezikshmet, që kërkonin besim, kurajë, vetëdije të lartë. Prej kësaj çete luftëtaresh do të binin dëshmore në ndeshje me armiq të katër shoqet e tyre Liri Gero, Penelopi Pirro, Taze Çela dhe Feride Bega. Heroina e popullit Liri Gero, e plagosur rëndë në betejë e sipër do të kapej nga nazistët, do të torturohej dhe pastaj do ta digjinin, duke e hedhur të gjallë në mes flakëve. Ishte kjo një vdekje, që vajza e thjeshtë myzeqare me emrin Liri i blatonte lirisë së atdheut. Do të qenë shoqet e shokët e saj më pas që do t’i merrnin hakun dhe do të vijonin më tej rrugën e luftës. Në këtë rrugë të lavdishme disa nga



vajzat do të shquheshin për trimëri, për vlera luftarake dhe cilësi të larta morale dhe do të meritonin detyra me përgjegjësi, duke u bërë komandante dhe komisarë të formacioneve partizane, drejtuese rinie dhe veprimtare politike. Në mes tyre s’mund të rrimë pa përmendur në radhë të parë emrat e organizatoreve dhe drejtueseve të kësaj çete luftëtaresh, komunistet Shpresa Hoxha (Fuga), Izmini Kokobobo dhe Manushaqe Qadhim, por dhe të tjerë emra si Gjinovefa Trebeshina, Ylvie Shehu, Shenisha Demi, Jorgjie Haxho, Liri Paloli, Liri Bozdo, Nedime Kryeziu, motrat Havari, Kristina Aleksi, Dhora Sota... Është ky një varg i artë emrash që vazhdon me të tjera dhe që kronika historike e kohës i ka të skalitura.

Dhe këto qenë vetëm një pjesë e 6000 vajzave dhe grave shqiptare që u ngritën në luftën antifashiste dhe u inkuadruan në radhët e formacioneve partizane. Një realitet i pangjarë ndonjëherë në tërë historinë shqiptare. Edhe kur kishte ngjarë, në raste tepër të rralla, si me Norën e Kelmendit, me Tringën e Malësisë apo Shote Galicën, ato kishin hyrë në këngë dhe kishin mbetur në kujtesën e popullit. Po atëherë ç’ mund të thuhet për ato mijëra partizane, që kronikanit të historisë do t’i dridhej dora nga emocioni për të shënuar emrat e tyre. E gjithë kjo e vërtetë që na nderon si popull liridashës, nuk mund mos të na vërë në mendime dhe të na bëjë të kthehemi në ato kohëra të rënda për fatin e atdheut, të cilit do t’i dilnin zot dhe vajzat e gratë shqiptare. Por, për hir të së vërtetës, duhet thënë se këtij akti madhor, iu kundërvunë në vitet e luftës forca konservatore e reaksionare, duke ngritur një stuhë shpifjesh e përbaltjesh, shoqëruar me fushata propagandistike të mbrapshta. Në të u përfshinë që nga shtypi zyrtar i qarqeve kuislinge të Tiranës e deri të forcat politike si Balli Kombëtar e Legaliteti, duke i quajtur këto vajza dhe gra si të përdala dhe mendjelehta, duke sajuar histori të paqena, mbushur me gënjeshtër dhe trillime fyese. Dhe kjo ndodhte në një kohë kur këto vajza e gra luftonin me vetëmohim krah shokëve të tyre, përballeshin me sakrificat të

panumërta, derdhnin gjakun duke lartësuar kështu figurën e tyre, moralin e tyre, virtytet e tyre të papërsëritshme. Historia objektive tanimë e njeh dhe e çmon këtë realitet madhështor të gruas shqiptare. Është ky kontribut kombëtar që hodhi themelet dhe hapi rrugën e emancipimit të saj në shoqërinë shqiptare të pasluftës. Të drejtat dhe pozita që ajo zuri më vonë nuk iu falën, por ajo i fitoi vetë, me gjak e me sakrificë, me prova të vlerave të saj të pamohueshme e të pazëvendësueshme.

Brezat e sotëm të femrës shqiptare duhet t’u jenë mirënjohëse simotrave të tyre partizane, sakrificave, guximit dhe ëndrrës deri në vetëflim që ato blatuan në emër të lirisë. Të lirisë jo vetëm kombëtare, por dhe të lirisë shoqërore, jo vetëm shoqërore, por dhe të lirisë shpirtërore e mendore, të çlirimit të saj nga gjithë ato pranga që e kishin kthyer në robinë.

Lufta Nacionalçlirimtare do të ishte fillimi i atij procesi, që këto robina i shndërroi në luftëtare dhe nga luftëtare në qytetare të lira, të zonjat e vetvetes. Një fenomen i madh qytetëruar në jetën e popullit tonë, që nuk mund të errësohet e të anashkalohej. Segment i këtij fenomeni është dhe akti i 68 vajzave që brenda një dite, të frymëzuara nga ideali i lirisë, u nisën të gjitha së bashku në luftë për çlirimin e atdheut të robëruar. Në kujtim dhe për nder të tyre është ngritur në mes të qytetit të Fierit lapidari prej bronzi i këtyre vajzave luftëtare. Një lapidar jo i zakonit që t’u kujtojë brezave të vërtetën e përjetshme se ai popull që harron të kaluarën, humbet dhe të ardhmen e tij.

Liri Gero, luftoi në Luftën e Dytë Botërore, së bashku me disa forca partizane, ajo u vra nga Nazistët gjatë një luftimi. Për heroizmin e saj, ajo mori titullin “Heroinë e Popullit”. Lindi në qytetin e Fierit dhe ishte aktiviste e luftës në qytet, partizane në brigadën XII Sulmuese. Ra dëshmore në tetor të vitit 1944.

Ajo mori pas vdekjes titullin “Heroinë e Popullit”. Monumenti i saj është vendosur në një nga parqet kryesore të Fierit që nga viti 2010. Një shkollë dhe një lagje në Fier gjithashtu mbajnë emrin e saj.



VERI TALUSHLLARI

“Fotografia që flet” është titulli i një libri të pabotuar i ish-skënderbegasit, shokut dhe kolegut tonë, Sali Frangu. Ideja e tij ishte vërtet interesante: të mblidhte një tufë fotografish nga jeta e njerëzve në Ushtri, dhe duke ndërtuar rreth secilës prej tyre një koment apo tregim të shkurtër, të nxirrte në dukje larminë e jetës ushtarake, ngjarje të zakonshme apo edhe heroike të burrave e grave që shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura, familjeve të tyre, me gëzimet, hallet, shqetësimet, ndjenjat dhe dëshirat... Me fjalë të tjera, lexuesi ta shihte jetën në ushtri, duke lexuar fotografitë. Për fat të keq, vdekja e parakohshme e të mirit dhe të diturit Sali Frangu, dy vjet më parë, e ndërpreu këtë projekt të bukur the original. Mbase së bashku me Idlirin, djalin e tij të mrekullueshëm, një ditë do ta mbarojmë projektin e Saliut. Nga Albumi im veçova dhe i dërgova këtë foto të 60 viteve më parë, pasi mendova se tregonte disa tipare të shëndetshme të jetës në Ushtri, si miqësinë dhe lidhjet e forta shoqërore e familjare, edukimin e kësaj fryme tek fëmijët apo nxitja e tyre për të vazhduar në gjurmët e prindërve me uniformë.

Ushtarakë dhe familjet e tyre në një ditë feste,
15 maj 1965, Leskovik

Në lëndinën, e rrethuar me arra dhe lajthi, akacie dhe pemë të tjera, që vendasit i thonë “Çaushko”, diku aty afër ku Përroi i Çarçovës hyn në atë grykën e ngushtë midis Malit të Melesinit dhe Malit të Postenanit, festohej Dita e Çlirimit të Leskovikut nga pushtuesit fashistë. I gjithë Leskoviku, qyteti dhe fshatrat përreth, ishte aty. Cicërimave të zogjve u bënin karshillëk tingujt e klarinetave dhe violinave, mandolinave e dajreve. Njerëzit, të veshur bukur, takoheshin, përshëndeteshin, uronin. Sidomos për ne fëmijët, gëzimi ishte i pafund, hareja e pamasë. Luanim, vraponim, thërrisnim, qanim se donim të blinim ëmbëlsira, lodra apo veshje në shitoret e ngritura enkas. Pastaj, pas fjalimeve dhe koncertit festiv, uleshim në batanijet që mamatë tona i shtronin mbi bar dhe hapnin tratstat e nxirrnin ç’ kishin gatuar një ditë më parë. Gjëra të mira sigurisht, të shijshme. Ne, familjet e ushtarakëve, uleshim bashkë, dy a më shumë familje. Baballarët ishin kolegë dhe shokë, nënat tona ishin shoqe dhe ne fëmijët po ashtu. Por kishte që uleshin me fise, madje edhe fshatçe. Biseda, këngë, valle, sipas qejfit. Kalonte aty pari fotografi dhe ja, ja ku është fiksuar ajo ditë. Ju shikoni pesë ushtarakë, por ulur janë edhe tre ushtarakë të ardhshëm dhe një e katërt, që do të lindte më vonë. Por tani më lejoni t’ua prezantoj. Çifti i parë majtas, është Koli dhe Ollga Ndreu. Të pashëm e të bukur si ata. Nuk di si dhe ku janë, se u transferuan në Fier, prej dhe nga ishin. Aty kanë jetuar deri vonë, por unë asnjëherë nuk munda t’i takoj. Në krah të tyre janë prindërit e mi, Parizja dhe Hajriu. Mamaja fare e re, 26-27 vjeçe the babi dhjetë vjet më i madh. E tepërt të them që kanë qenë prindër dhe njerëz të mrekullueshëm. Rritën tre fëmijë së bashku, gjithnjë larg vendlindjeve të tyre - mamaja ishte nga Zhepa e Tomoricës, Skrapar, dhe babi nga Zereci i Oparit, Korçë, - por kurrë nuk i harruan prindërit, motrat e vëllezërit e tyre dhe me këtë ndjenjë na rritën edhe ne. Si të gjithë prindërit ata u kujdesën e sakrifikuan aq shumë për edukimin dhe shkollimin tonë, të bëheshim të ditur dhe të zotë. Sot, atje në qiell ku besojmë se janë, u jemi mirënjohës për gjithçka bënë për ne. Edhe diçka: babai duket i gëzuar, sepse para se të bëhej kjo foto-ai ishte artiljer tokësor - kishte përgatitur një grup djemsh e vajzash shkollarë, dhe para popullit dhe udhëheqjes së asaj kohe, u bë qitje reale me mortaja. Predhat ranë në shenjë, në qendër të disa rrathëve të bërë më gurë të bardhë. Populli duartrokiti djemtë dhe vajzat e tij ushtarë, e sigurisht edhe ne ishim krenarë për babanë. Në krah të prindërve të mi është çifti Nado dhe Tajar Velaj. Në atë kohë ata kishin dy vajza, Mondën the Elvirën. Vajza e tretë, Bajamja, që do të bëhej oficere, nuk ishte lindur ende. Velajt ishin leskoviqarë, por kur pas dy-tre viteve, Brigada e 14-të do të zhvendosej në Përmet, ne përsëri ishim fqinjë, në atë lagjen e bukur “Bajame”, buzë Vjosës

“FOTOGRAFIA QË FLET”



së zhurmshme dhe të magjishme. Në të vërtetë, katër familjet në foto, përveç çiftit Ndreu, ishim fqinjë edhe në Përmet. Çifti tjetër janë Feim e Bukurie Canaj, një çift i mrekullueshëm tepelenas. Me këtë familje, ne Talushllarët kemi qenë shumë të lidhur, dhe, edhe sot e kësaj dite që prindërit tanë s’janë më mes nesh, ne kemi lidhje shumë të forta shoqërore e familjare. Ne kemi qenë fqinjë edhe në Berat e më vonë edhe në Tiranë. Një jetë pranë njëri-tjetrit, në të mirë e në të keq. Një shembull i bukur i atyre marrëdhënieve e lidhjeve që mund t’i farkëtojë vetëm Ushtria, jeta ushtarake, që shumë herë dalin nga repartit dhe shtrihen deri në familje. Çifti në të djathtë janë Shefiko dhe Hysni Llakaj, tepelenas dhe ata, dy njerëz të mirë, të qetë, të dashur. Ata rritën pesë fëmijë, katër djem e një vajzë, njëri më i mirë se tjetri, të gjithë të bukur e shtatlartë, si duket morën më shumë nga e ëma. Dhe ja ku jemi tani ne, fëmijët e tyre. I pari është një nga binjakët Canaj, Zeqiri, tjetri, Hyseni është i katërti në foto, aq të ngjashëm me njëri-tjetrin sa edhe pse të rritur me ta, i ngatërronim. Fatkeqësisht Hyseni u nda i ri nga kjo jetë, pak mbi të dyzetat. I dyti është vëllai i tyre i madh, Zamir Canaj, shoku im nga dita që jam lindur e edhe sot e kësaj dite. Me Zamirin kemi qenë skënderbegas dhe studentë ushtarakë, ai gjithnjë

U BËRA OFICER SI BABAI, DHE
KARRIERËN E MBYLLA NË
BAZËN AJRORE TË KUÇOVËS
NË VITIN 2001, KUR SË
BASHKU ME BASHKËSHORTEN
TIME TË MREKULLUESHME,
DRITËN, VAJZË E NJË OFICERI
TË NDERUAR, ALI MANUKËS,
DHE ME VAJZËN TONË TË
SHTRENJTË, ANËN, EMIGRUAM
NË SHBA, U VENDOSËM NË
NJU JORK, KU JETOJMË EDHE
SOT. KAM NJË VEPRIMTARI
MODESTE LETRARE DHE
GAZETARESKE.

një vit para meje. Pastaj jeta na ndau, ai fillimisht në Sazan dhe repartet e Bregdetit, unë në Devoll, Fushën e Korçës dhe repartet e Beratit. Pa dyshim, kur vij nga Nju Jorku në Tiranë, Zamiri dhe Zeqiri janë nga të parët që takoj. I treti, në këmbë, është vëllai im i vogël, Alfredi, tani një taksist i dalluar në kryeqytet the baba i dy djemve të mrekullueshëm. Ajo vajza që ka dorën te goja është Rajmonda Velaj, dhe në të majtë të saj, mbajtur te dora e mamasë së vet, është Elvira Velaj, sot një mjeke e zonja. Me atë beben në prehër është Vjollca Llakaj, bashkëmoshatarja ime. Me Vjollcën kam foto që kur ishim në kopsht e më pas në shkollë. Po kë mban në prehër? Ah, për këtë nuk jam i sigurt. Mbase vëllain e saj të vogël, Ilirin, apo vajzën e Ollgës? Më tepër ka mundësi kjo e dyta. Ulur pranë saj është motra ime, Eglantina. Siç është në foto, ashtu dhe ka mbetur, e bukur, e urtë, e qetë, por qeni shkopin s’ia ka ngrënë. U bë një mësuese e aftë e anglishtes, drejtoi për shumë vite një institucion të shëndetit mendor dhe rriti një vajzë dhe një djalë po aq e mbase më të zotët se nëna e tyre. Tani është një gjyshe e lumtur në Virxhinia, SHBA. Pastaj është Raimondi, nën përqaftimin e vëllait të tij më të madh, Robert Llakajt. Për Bertin do të flas pak më gjatë. Ai ishte më i madhi mes nesh dhe u bë shembulli ynë. Ishte një djalë shumë inteligjent, por së pari të bënte përshtypje bukuria fizike dhe përsosmëria trupore e tij. Në vitin 1968 ai iku në shkollën “Skënderbej” dhe gjurmët e tij i ndoqëm Zamiri dhe unë pas dy dhe tre vjetësh. U bë një djalosh shtatlartë dhe bukurosh, me një zë të ulët e të folur të qetë, të matur, cilësi që të bënin për vete. Kushdo që e njihte kish dëshirë ta kish shok e mik. Sidomos kur vajta në vitin e parë, padyshim viti më i vështirë për çdo skënderbegas, - Berti ishte maturant, - mu bë vëlla e shkuar vëllait. Asnjëherë nuk më mungoi fjala, përkrahja, këshilla e tij. Interesohej për mbarëvajtjen në mësim, më merrte në stadium kur luante “Partizani”, me të kam shkuar për herë të parë në Teatrin Kombëtar, etj. Pas Shkollës ai shërbeu në Kukës disa vjet dhe më pas pedagog në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve. Për të ardhur keq që u nda nga jeta aq para kohe, sa mbushi të 60-at, por jam i gëzuar që, edhe pse larg, jam mik me djalin e tij, Ergysin dhe patjetër me Mondin dhe vëllain tjetër, Fatmirin, në këtë foto në krahët e të atit. Mili, siç i thoshim dhe i themi edhe sot, është në Itali. Dhe i fundit në foto, gjithashtu nën përqaftimin e Bertit, jam unë, dora vetë. Nuk kam shumë të tregoj për veten. Siç thashë, u bëra oficer si babai, dhe karrierën e mbylla në Bazën Ajrore të Kuçovës në vitin 2001, kur së bashku me bashkëshorten time të mrekullueshme, Dritën, vajzë e një oficeri të nderuar, Ali Manukës, dhe me vajzën tonë të shtrenjtë, Anën, emigruam në SHBA, u vendosëm në Nju Jork, ku jetojmë edhe sot. Kam një veprimtari modeste letrare dhe gazetareske. Ja pra, kjo është pak a shumë ajo që tregon kjo foto. Nuk di sa arrita të bëj një homazh për ata që nuk janë më mes nesh, dhe të shpreh ndjenjat më të mira për shokët dhe miqtë e mi të vegjëlisë, rinisë dhe tashmë edhe të prag-pleqërisë. Megjithatë, edhe njëherë dua t’ju them se ju dua shumë.



Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2024 - 2025.

30 (tridhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve, ku arsimi universitar i përfaqësohet si vijon:

- Ndërlidhje - 9 kuota (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike)
- Logjistikë - 7 kuota (Fakulteti Ekonomik, Financë)
- Xhenio/Infrastrukturë - 3 kuota (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit)
- Forcë Tokësore, Detare, Ajrore, Komandë Mbështetëse - 14 kuota (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Transport)
- Mjekësi - 2 kuota, (Fakulteti i Mjekësisë)

**Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit
është deri më 23 gusht 2024.**

urly.it/3a6gw

Tel: 042 348 588